

Studimi mbi Shpërndarjen e Armëve të Vogla dhe të Lehta

TABELA E MËPOSHTME jep shifrat e përlogaritura për numrin total të AVL-ve në Shqipëri. Të dhënat janë hartuar në bazë të një numri të caktuar burimesh duke përfshirë dokumentat zyrtare, intervistat dhe të dhënat e nxjerra nga sondazhet e opinionëve. Prandaj këto të dhëna duhen analizuar me kujdes, duke patur parasysh vështirësinë e arritjes së niveleve të kënaqshme të saktësisë nga ana e vlerësuesve.

Tabela 10: Numri i përlogaritur i AVL në Shqipëri

Mbajtësi i AVL	Nr i përafërt i njësive
Armët e ushtrisë aktive dhe të rezervistëve	35,000 ¹⁸⁷
Teprica e MM	88,742–138,742 ¹⁸⁸
Policia e MRP	23,930 ¹⁸⁹
Garda e Republikës	2,112–3,696 ¹⁹⁰
Polici të ministrive të tjera	983 ¹⁹¹
Kompanitë e Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike	938 ¹⁹²
Armët e mbajtura me leje	65,747 ¹⁹³
Armët pa leje në Shqipëri	Afërsisht 200,000 or 150,000–250,000
Totali i përlogaritur i AVL-ve në Shqipëri	440,000¹⁹⁴

Gjithashtu, është përlogaritur në mënyrë mjaft të përafërt që 117,875 AVL të grabitura janë trafikuar në Shqipëri që nga viti 1997.

¹⁸⁷ Intervistë, zyrtarët e MM, 18 korrik 2005.

¹⁸⁸ Burimet dhe metodologjia si në seksionin 3.1 "Armët e MM" më poshtë.

¹⁸⁹ Metodologjia si më poshtë në seksionin 3.2 "Armët e MRP" Burimi: MRP, Raporti vjetor I vitit 2004i MRP(Tiranë, 2005), fq.20, Intervistë, zyrtar i MRP, 19 korrik 2005.

¹⁹⁰ Përlogaritjet për AVAL që ka në zotërim Garda e Republikës bazohen në shifrën e 1.056 punonjësve, me shifrat e dhëna të shumëzuara me dy dhe 3.5. Burimi: op cit MRP, fq.20.

¹⁹¹ Kjo shifër është marrë nga drafti i Strategjisë Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Kontrollin e AVL. Fatkeqësisht, ajo nuk ofron një ndarje më të detajuar për ministritë e ndryshme. Burimi: drafti i Strategjisë Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Kontrollin e AVL, Republika e Shqipërisë, viti 2004. (të cilit tani e më vonë do ti referohemi si Drafti i Strategjisë Kombëtare për AVL).

¹⁹² Op cit Drafti i Strategjisë Kombëtare për AVL

¹⁹³ Po aty.

¹⁹⁴ Bazuar në shumën e shifrave të mësipërme duke përdorur mesataret dhe duke e rumbullakosur nga një total prej 443.244.

3.1 Armët e MM

Shifra prej 35.000 AVL ushtarake u dha nga zyrtarët e MM, të cilët deklaruan që personeli i ushtrisë aktive është 10.000, me një mesatare prej 3,5 armësh për çdo ushtar.¹⁹⁵ Shifrat për forcat detare dhe ajrore nuk u morën parasysh, kështu që shifra totale është padyshim më e madhe se kaq.

Përlllogaritja e tepricës është bërë duke mbledhur së bashku numrin total të AVL-ve të grumbulluara dhe pjesën e përlllogaritur të AVL të cilat nuk u grabitën në vitin 1997. Nga këto përlllogaritje fillestare, duhen zbritur AVL-të të cilat u shkatërruan ose ju dhanë ushtrisë, policisë apo shërbimeve të tjera shtetërore, ekspozitave, biznesmenëve apo banorëve të kufirit.

Tabela 11: Numri i përlllogaritur i tepricës së AVL të mbajtura nga ushtarakët shqiptarë

Totali i AVL të mbledhura	222,918 ¹⁹⁶
AVL të përlllogaritura të cilat nuk u grabitën nga depot në vitin 1997	50,000 ¹⁹⁷ –100,000 ¹⁹⁸
Përlllogaritja fillestare e tepricës së AVL-ve	272,918–322,918
Totali i AVL-ve të shkatërruara (2000–2004)	– 141,000 ¹⁹⁹
AVL e mbledhura të marra nga MM për shërbimin aktiv dhe të rezervës	– 35,000 ²⁰⁰
AVL të mbledhura të dhëna policisë së MB, ekspozitave, biznesmenëve dhe banorëve të kufirit	– 8,176 ²⁰¹
AVL e transferuara	– ?
Teprica totale e AVAL	88,742–138,742

Këto shifra janë gjithashtu relativisht të përafërta me përlllogaritjet e sugjeruara nga dy burime të ndryshme. Së pari, një shifër prej rreth 80.000 AVL iu sugjerua ekipit studimor nga kompania këshilluese amerikane SAIC, e cila po i jep konculencë ushtrisë shqiptare në lidhje me ristrukturimin e saj.²⁰² Së dyti, tek shifra prej 126.039 mund të arrihet duke zbritur 25.000 AVL të shkatërruara në vitin 2004 nga teprica e AVL prej 151.039 të regjistruara me Urdhër të Qeverisë mbi Dekomisionin e AVL, gjë që ofroi një listë të plotë të tepricës së AVL në bazë të një inventari të depove shqiptare në vitin 2002.²⁰³ Sigurisht, që të dyja këto shifra janë disa mijra AVL më të ulëta se përlllogaritjet e bëra më sipër, por ato mund të sugjeronin që teprica është brenda gamës 80.000–140.000.

Ka të ngjarë që transfertat e tepricës së AVL të mund të kenë reduktuar nivelet e tepricave shtetërore. Edhe pse u informuam që AVL e mbledhura që nuk ishin në përdorim nga MM, MRP, biznesmenët dhe banorët e kufirit, ishin të destinuara të shkatërroheshin, sipas shifrave të publikuara nga MEICO, AVL me vlerë prej 3.258.917 USD u shitën gjatë viteve 2000 dhe 2004.²⁰⁴ Gjithashtu, në vitin 2002, Shqipëria i dhuroi Afganistanit 600 pushkë luftarake dhe një numër të pacaktuar mitrolozesh.²⁰⁵ Ka të ngjarë që burimet e këtyre shitjeve të kenë qenë depot e MM, por nuk është e qartë se sa AVL janë shitur apo janë hequr mënjanë për tu shitur. Totali i tepricës së transferuar duhet të marrë në konsideratë gjithashtu rastet e dokumentuara të transfertave në destinacione sensitive jo të pranuar në shifrat e MEICO- në rastin e transfertave në Ruandë të cilat gjoja shkuan në Kongo në vitin 2003, kjo gjë mund të ketë reduktuar sasinë e tepricës së armëve dhe municionit deri në 400 ton.²⁰⁶ Një burim ka sugjeruar që MEICO është në gjendje të ofrojë për shitje më shumë njësi të

¹⁹⁵ Intervistë, zyrtarë të MM, 18 korrik 2005.

¹⁹⁶ Burimi: Të dhënat mbi mbledhjen e armëve nga MRP, korrik 2005.

¹⁹⁷ Intervistë, përfaqësues i OJQ-së, 23 korrik 2005.

¹⁹⁸ Kjo shifër bazohet mbi faktin që përlllogaritjet fillestare zyrtare të AVL të grabitura në vitin 1997 ishin 650.000, që u reduktuan në rreth 550.000 pas një inventari kombëtar. Mendohet që përlllogaritja fillestare supozoi që të gjitha depot ishin plaçkitur. Sidoqoftë, kjo do të ishte një përlllogaritje konservatore.

¹⁹⁹ Intervistë, zyrtarë të MM, 14 prill 2005.

²⁰⁰ Intervistë, zyrtarë të MM, 18 korrik 2005.

²⁰¹ Burimi: Të dhënat mbi mbledhjen e armëve nga MRP, korrik 2005.

²⁰² Intervistë telefonike, SAIC, 20 korrik 2005.

²⁰³ Intervistë, zyrtarë të MM, 14 prill 2005.

²⁰⁴ Shih tabelën për transfertat e MEICO në Shtojcën 1.

²⁰⁵ "Ministria shqiptare e Mbrojtjes konfirmon dhurimin e pushkëve luftarake ushtrisë afgane", AFP (Paris), 28 nëntor.

²⁰⁶ Shih seksionin 5.1.1.5 "Transfertat e shqetësimit" dhe Amnesty International, "Republika Demokratike e Kongos-armatosja e lindjes" AFR, 62/006/2005, e disponueshme në <http://web.amnesty.org/library/index/engaf620062005>

AVL sesa shifra më e lartë e tepricës prej 138.742 e dhënë më sipër.²⁰⁷ As informacioni i cili është publikisht i disponueshëm në lidhje me detajet e transfertave të AVL shqiptare, as edhe deklaratat e transfertave, nuk krijojnë një bazë solide për të përlogaritur se sa janë reduktuar sasisë e armëve në këtë drejtim. Një transparencë më e madhe përsa i përket llojit dhe sasisë së mallrave të transferuara do të mundësonte përlogaritje më të sakta të armëve të marra në zotërim nga shteti, si edhe zhvillimit të një diskutimi mbi zgjidhjet e duhura për vështirësitë që hasen në lidhje më menaxhimin e armëve gjendje.

Reformat që bëhen aktualisht në ushtri, do të vazhdojnë të krijojnë tepricë AVL në vitet e ardhshme përmes reduktimit të personelit të ushtrisë aktive. Më tej, shpenzimet për ushtrinë pritet të rriten nga 1.3 përqind e GDP-së që ishin në vitin 2005, në 2 përqind të GDP-së në vitin 2010.²⁰⁸ Pajisjet e reja janë përcaktuar si fusha ku do të synohet të përdoren fondet e buxhetit të rritur. Prandaj, pritet që teprica e AVL të rritet meqë ushtria shqiptare do të marrë pajisje të reja.

Përsa i përket municioneve, zyrtarët e MM tregojnë që kanë asgjësuar tashmë rreth 32.000 ton, ndërsa për vitin 2005, mbi 85.000 ton municion i prodhuar në Shqipëri, Kinë dhe BS ende është në depo. Ata më tej llogarisin që rreth 70 përqind e kësaj sasive, është mbi 35 vjeçare. Këto shifra duhet të shqyrtohen me kujdes duke patur parasysh organizimin e keq dhe regjistrimin me të meta në shumë depo, për të cilat do të diskutojmë më poshtë në seksionin 5.1.1.2- "Menaxhimi i armëve gjendje". Një përlogaritje alternative e bërë nga një ish-zyrtar i NAMSAs ishte që sasia gjendje e municionit është në fakt rreth 150.000 ton, nga e cila rreth 2.000 ton është i papaketuar.²⁰⁹

3.2 Arsenali i MB

Përlogaritja e AVL që zotëron policia e MB bëhet në bazë të shifrës prej 11.965 oficerësh policie të të gjitha rangjeve,²¹⁰ e cila shumëzohet me dy armë për çdo oficer. Shumëzimi bëhet duke u mbështetur në faktin që shefi i arsenalit të MB deklaroi që çdo oficer policie është pajisur me një pistoletë dhe pushkë luftarake.²¹¹ Pra, përlogaritja e AVL-ve që zotëron MPB është 23.930. Sidoqoftë, shefi i arsenalit, deklaroi gjithashtu që pothuajse shumica e pistoletave që u mbledhën nga oficerët e policisë dhe skuadrat e grumbullimit të armëve u janë rishpërndarë efektivave të policisë pasi ato janë testuar.²¹² Në përgjithësi, sidoqoftë, numri i pistoletave të mbledhura është i vogël, madje numri i atyre që gjykohen si të përshtatshme për tu përdorur është edhe më i vogël. Sipas shefit të arsenalit, ata janë mbështetur për pajisje në dhurimet e ndyshme ndërkombëtare, dhe kanë ende nevojë për mjete më moderne, AVL dhe trajnim të specializuar në përdorimin e armëve të zjarrit. Ai nuk e mban mend herën e fundit që u dha një urdhër për pajisjen e policisë me AVL. Prandaj, shifra prej 23.930 AVL për policinë e MB mund të jetë pak më e lartë se numri aktual i tyre.

²⁰⁷ Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 23 korrik 2005.

²⁰⁸ M. Jazbec, Reforma e Mbrojtës në Ballkanin Perëndimor: Rruga përpara, (DCAF, prill 2005), fq. 8.

²⁰⁹ Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 19 prill 2005.

²¹⁰ Kjo shifër përfshin nëpunësit civilë dhe stafin administrativ. Burimi: MRP, Raporti vjetor I vitit 2004 I Ministrisë së Rendit Publik, (Tiranë, 2005), fq. 20.

²¹¹ Intervistë, zyrtar I MRP, 19 korrik 2005.

²¹² Intervistë, zyrtar I MRP, 26 prill 2005.

3.3 Kompanitë e Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike (KRSF)²¹³

Shifra për numrin e AVL të KRSF-ve është marrë nga drafti I Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Kontrollin e AVL.²¹⁴ Ndarja e llojeve të ndryshme të AVL, që janë regjistruar nga KRSF-të në vitin 2004, jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 12: Numri i AVL të regjistruara nga KRSF-të

Lloji i AVL	Nr i njësive
Pistoleta	162
Pushkë automatike	767
Pushkë	9
Totali	938

Në vitin 2004, MB përllorarit që kishte 269 KRSF të licensuara në Shqipëri, të cilat kishin punësuar 4.093 roje sigurimi. Kjo jep një mesatare prej 3.5 AVL të regjistruara për çdo KRSF të licensuar, dhe sugjeron që një maksimum prej 6.5 përqind rojesh sigurimi mund të armatosen në të njëjtën kohë. Sidoqoftë, një burim ka raportuar që rreth 60 AVL janë regjistruar vetëm nga një KRSF në Shkodër,²¹⁵ që sugjeron që numri i AVL që kanë KRSF-të mund të ndryshojë shumë nga njëra te tjetra. Është një praktikë mjaft e zakonshme për KRSF-të të pajisin me armë zjarri vetëm skuadrat e ndërhyrjes së shpejtë, megjithëse edhe rojet e bankave apo individët gjithashtu priren drejt mbajtjes së armëve të zjarrit.

Praktika e përgjithshme është që armët dhe municionet të magazinohen në mjediset e kompanisë si edhe të regjistrohen në një regjistër. Disa kompani, kanë gjithashtu rregullore të brendshme për magazinimin e tyre, ndërsa kompanitë më të mëdha mendohet se kanë standarte mjaft të mira ruajtjeje. Sidoqoftë, është raportuar gjithashtu që, armët i dorëzohen rojës tjetër në fund të turnit dhe pa u futur në depo. Në raste të tjera, është raportuar që rojet i marrin pistoletat me vete në shtëpi.²¹⁶ Si rrjedhim, jo të gjitha kompanitë i zbatojnë rregulloret dhe normat e magazinimit të sigurt të armëve të zjarrit dhe municioneve ashtu si përcaktohet në manualet e policisë. Pra, ekziston rreziku që armët që u jepen rojeve për shërbimin e sigurisë, nuk përdoren vetëm për këtë gjë.

3.4 Përlloraritja e numrit të AVL të trafikuar

Si u tha në hyrjen e këtij raporti, trafikimi i AVL përbën një problem serioz si për Shqipërinë, ashtu edhe për të gjitha vendet e tjera të rajonit të Europës Juglindore, dhe problemi vazhdon të jetë edhe sot por në një shkallë më të ulët. Është llogaritur që në total rreth 100.000–150.000 AVL janë trafikuar nga Shqipëria në periudhën 1997–2002. Një artikull i botuar në vitin 2002, citon një deklaratë të shefes së zyrës së UNDP në Tiranë, Ana Stjarneklint, në të cilën jepet kjo shifër.²¹⁷ Një raport tjetër i vitit 2003, sugjeron që kjo shifër është dhënë nga Qeveria²¹⁸, dhe ishte shifra më shumë e cituar që kishte hasur skuadra e kërkimit. Ish- nën Sekretari i Përgjithshëm i OKB -së për çështjet e çarmatimit, Jayantha Dhanapala, u shpreh gjatë një vizite në Shqipëri në qershor 1998, se “diku rreth 25–30 përqind të armëve që nuk i janë dorëzuar Qeverisë mund të jenë nxjerrë jashtë vendit si nga individë të ndryshëm ashtu edhe nga grupe që merren me veprimtari kontrabandë”.²¹⁹ Raporti mbi vizitën e tij thekson që Dhanapala sugjeroi që pathuajse 200.000 AVL kanë hyrë kontrabandë në Kosovë,

²¹³ Informacioni për këtë seksion është marrë nga :M.Page, S. Rynn, Z. Taylor, dhe D.Wood, “ AVAL dhe KRSF-të në Europën Juglindore: Shkak apo pasojë e Pasigurisë?”, (Beograd, SEESAC/Saferworld/International Alert,2005).

²¹⁴ Op cit Drafti I Strategjisë Kombëtare për AVAL.

²¹⁵ Intervistë, zyrtar i MRP, 14 qershor 2005.

²¹⁶ Vetëm 3.1 përqind e pjesëmarrësve të sondazhit të bërë nga ISO për një Botë më të Sigurtë, mendonin që rojet duhet të lejohen ti marrin me vete në shtëpi AVAL.

²¹⁷ A Bala, “Mbledhja e armëve në Ballkan”, Radio Free Europe / Radio Liberty Newslines, 6(70), 15 prill 2002

²¹⁸ Op cit D. Quin dhe të tjerët.

²¹⁹ “Kosovë: OKB llogarit 200.000 armë të trafikuar nga Shqipëria”, Paris AFP (Shërbimi për Europën Perëndimore në Anglisht, 2056 GMT, 14 korrik 1998. Burimi: NISAT Black Market Archive Database, <http://www.nisat.org/>, 17 maj 2005.

Maqedoni dhe destinacione të tjera të pacaktuara.²²⁰ Sidoqoftë, në intervistat tona me antëtarë të forcave të anti-trafikut në Shqipëri, policisë kufitare dhe asaj doganore, nuk u dhanë shifra. Pjesëmarrësit në këto fusha nuk mendonin që ishte bërë një analizë e detajuar për të nxjerrë një shifër të besueshme.

Tabela 13: Numri i përlogaritur i armëve të trafikuar sipas destinacioneve të ndryshme në periudhën 1997–2002

Destinacioni	Shifra e llogaritur e armëve të trafikuar
Grupet rebele etnike shqiptare	40,000
Refugjatët nga kriza e Kosovës	39,375
Greqia	38,500
Total	117,875

Është sigurisht pothuajse e pamundur që të thuhet me saktësi se sa prej AVL-ve të grabitura janë trafikuar nga Shqipëria qysh prej vitit 1997, duke mos marrë parasysh numrin e AVL-ve të grabitura që janë trafikuar nga, në, dhe nëpërmjet Shqipërisë që prej vitit 1991. Me shikim të parë, shifra prej 150.000 njësisë të trafikuar nga vendi që prej 1997, garanton për një analizë të mëtejshme për shumë arsye: së pari, terreni përmes të cilit thuhet se është bërë trafikimi, do ta ketë vështirësuar shumë trafikimin e kaq shumë njësie nga pikpamja logjistike,²²¹ së dyti llogaritjet më të sakta të për armët që kanë grupet etnike rebele shqiptare, të cilat dihet se e kanë burimin nga armët e mbajtura pa leje në Shqipëri, sugjerojnë që sasia e tyre totale gjendje nuk mund të arrijë kurrë më shumë se 63,520 copë maksimumi.²²² Sasia totale e armëve të kombinuara ka të ngjarë të ishte shumë më e vogël, dhe shumë prej tyre nuk mund të kenë ardhur nga Shqipëria. Për më tepër, totali i armëve të trafikuar nga Shqipëria me të cilat janë furnizuar grupet rebele, nuk mund të nxirret duke mbledhur armët që zotëron çdo grup në bazë të llogaritjeve të bëra nga burimet shqiptare, meqë ka të dhëna që UNÇ, UÇPMB dhe grupe të tjera rebele etnike shqiptare kanë marrë armë që më parë përdorshin nga UÇK.²²³ Prandaj, është llogaritur që jo më shumë se 40.000 armë janë trafikuar ndonjëherë nga Shqipëria për të furnizuar lëvizjet etnike rebele shqiptare pas vitit 1997. Shumica e komentuesve janë të mendimit që trafikimi i shpeshtë dhe në shkallë të madhe i armëve nga Shqipëria apo përmes saj, përbën një kontigjent konfliktesh brenda rajonit të Europës Juglindore,²²⁴ duke konsideruar Kosovën dhe Maqedoninë si destinacionet kryesore për dërgimin e armëve të ardhura nga Shqipëria apo që kalojnë ndërmjet saj.²²⁵ Të intervistuarit e informuan ekipin e studimit se që në vitin 2003 nuk ishin kapur armë në kufirin e Shqipërisë me Kosovën dhe në atë me Maqedoninë.²²⁶

Kuti: Sa armë u trafikuan tek grupet etnike rebele shqiptare pas vitit 1997?

Ushtria çlirimtare e Kosovës (UÇK) besohet se është armatosur nga burime të ndryshme, duke përfshirë Shqipërinë, Bullgarinë, Rumaninë, Republikën Çeke, Serbinë si edhe disa nga vendet antare të NATO-s, ndërkohë që të paktën një dërgesë armësh nga Kroacia u kap nga autoritetet jugosllave.²²⁷ Sidoqoftë llojet e armëve të mbledhura gjatë iniciativave të çarmatimit dhe kapjeve të tyre, si dhe intervistat me ish-luftëtarë, sugjerojnë që pavarësisht nga blerja e armëve nga një sërë vendesh të tjera, armët e grabitura në Shqipëri përbënin të paktën 50% të armëve të

²²⁰ Po aty.

²²¹ Vështirësi logjistike e trafikimit të 150.000 armëve në terren malor tek grupet klandestine të angazhuara në rebelime të vogla pa u pikasur, bëhet mjaft e qartë nëse marrim parasysh faktin që çdo armë e llojit AK peshon afërsisht rreth 3 kg. Duke supozuar që kjo është pesha mesatare për njësi, mbi 450 ton armë janë kaluar përmes kufirit nëse shifra prej 150.000 armësh të trafikuar është e saktë. Për më tepër, dendësia e çelikut është afërsisht 7900 kg/m³, prandaj në bazë të formulës $D=M/V$, janë transportuar mbi 56.96 m³. Nëse marrim parasysh edhe vëllimin e boshllëqeve të ajrit dhe paketimit do të ishte e saktë të thonim që vëllimi real është 4 herë më i madh se kaq, i barabartë me 228 m³. Një kontejner standart ISO, ka një vëllim prej 38.5 m³, prandaj transportimi i sasisë prej 150.000 armëve do të kërkontë praninë në këtë rajon e të paktën 6 kontejnerëve standartë ISO. Edhe eksporti i municioneve të nevojshme për këto armë, do të paraqiste të njëjtat vështirësi.

²²² Intervistë, zyrtar i MRP official, 25 prill 2005; Quin, 2003.

²²³ Nuk ka dyshim që UNÇ të jetë furnizuar me armë nga Kosova, prandaj u ndërmor (deri tani i suksesshëm) operacioni i KFOR-it për të forcuar kufirin dhe për të penguar furnizimin e UNÇ me armë. N. Barnett "KFOR gjurmon evolucionin e radikalëve shqiptarë" *Jane's Intelligence Review*, 01 maj 2001.

²²⁴ Intervista, zyrtar i MRP, 20 prill 2005, zyrtar i MRP 25 prill 2005, zyrtar i MRP 20 prill 2005, zyrtar i MRP 20 prill 2005.

²²⁵ Op cit Smith dhe Sagramoso, fq. 27–28

²²⁶ Intervistë me një zyrtar të MRP, 25 Prill 2005; Quin 2003

²²⁷ A Heinemann-Grüder A dhe W-C Paes, "Qeni tund bishtin: Mobilizimi dhe Çmobilizimi i UÇK" (BIIC, Bonn, 2001), fq. 13.

përdorura nga UÇK, UNÇ, dhe UÇPMB.²²⁸ Në kulmin e tij, arsenalin e UÇK do të kishte qenë pak a shumë i mjaftueshëm për të armatosur afërsisht 20.000 luftëtarë.²²⁹ Megjithatë shifrat rreth arsenalit të tyre kanë shkruar deri në 100.000 AVL, deklarata që numri i armëve mbetet “i varfër dhe i pamjaftueshëm” do të thotë që maksimumi i arsenalit total të armëve të UÇK, të ketë qenë më i ulët se shifrat 32.000–40.000 të dhëna nga Studimi për Armët e Vogla.²³⁰

Në vitin 2001 Zoran Kusovac tha që UNÇ në Maqedoni kishte rreth 10.570–14.050 njësi AVL (duke përfshirë edhe 5.000 mina)²³¹, ndërkohë që SEESAC, Studimi për Armët e Vogla dhe Studimi i BIIC për AVL në Maqedoni e vlerësoi arsenalin e tyre si ndërmjet shifrave 8.210 (besueshmëri e madhe) dhe 20.000 (besueshmëri e ulët).²³²

Numri i antarëve të UÇPMB-së është vlerësuar si 2.200 në kulmin e tij, i cili duke përdorur shumëzuesin për rebel të Studimit për Armët e Vogla prej 1.6 do të thotë që ajo kishte deri në 3.520 armë, shumë nga të cilat përsëri, do të kenë qenë armë të ardhura nga totali i UÇK-së dhe jo të blera rishtas nga Shqipëria.²³³ Megjithatë të tjera rebele shqiptare (si ANA, UÇPG dhe UÇK-L) mendohet se i kanë armatosur 4.900 antarët e tyre nga arsenalin gjendje i UÇK-së,²³⁴ arsenalin e tyre nuk i shtohet shifrës së armëve të trafikuar nga Shqipëria që nga viti 1997. Arsenalin maksimal përbashkët i llogaritur i UÇK-së, UNÇ-së dhe UÇPMB-së është atëherë 63.520 armë, prej të cilave 40.000 supozohet se kanë ardhur nga Shqipëria (duke patur parasysh burimet e tjera të njohura të armatimeve, si edhe faktin që shumë prej tyre janë përdorur nga më shumë se një grup).

Sidoqoftë, kishte blerës të tjerë të armëve të trafikuar nga Shqipëria pas vitit 1997, të cilët mund të kenë hasur më pak pengesa në transportimin e armëve të grabitura: individë të caktuar si p.sh. refugjatët, gjithashtu morën armë me vete jashtë vendit për mbrojtje personale. Nuk ka metoda të verifikueshme për të llogaritur numrin e armëve të përdorura në këtë mënyrë. Sidoqoftë dihet që afërsisht 450.000 refugjatë që u larguan për shkak të konfliktit në Kosovë, u futën në Shqipëri.²³⁵ Një informator i rëndësishëm thotë që 70% e grupimeve familjare mund ti kenë marrë armët me vete gjatë rrugës për në Shqipëri, dhe në përgjithësi refugjatët lëviznin në grupe familjare prej 8 vetësh. Kjo do të jepte një përllogaritje të afërsme të numrit prej 39.375 armësh që kishin me vete refugjatët e kthyer.²³⁶ Megjithatë kjo shifër nuk është shumë e besueshme, rrjedha e armëve që potencialisht shoqëruan refugjatët nuk mund të zbritet nga llogaritjet për armët e trafikuar.

Përllogaritja e numrit të armëve të trafikuar përmes kufirit grek për shitje tek kriminelët është gjithashtu një temë e vështirë. Në vitin 1999, një gazetë greke raportoi se zyrtarë grekë vlerësuan se 150,000 armë të vogla dhe të lehta kishin hyrë në Greqi

²²⁸ Nga 15 ish-luftëtarë të UÇK që u intervistuan “9 prej tyre treguan që Shqipëria ishte kanali më i rëndësishëm i armëve pas 1997” ndërkohë që “armët e blera nga burime në Serbi përbënin 5–25 përqind të totalit të armëve të UÇK.” A. Khakee, N. Florquin, “Kosova dhe Armët: Një vlerësim i kufizuar i AVAL në Kosovë”, (Gjenevë, Studimi për AV/PNUD, qershor 2003), fq.13, 14. T. Ripley, “‘T’ Arsenalin i UÇK”, *Jane’s Intelligence Review*, 01 nëntor 2000

²²⁹ “Është e pamundur të jepet një vlerësim përfundimtar përse i përket fuqisë së trupave në fund të konfliktit në qershor të vitit 1999. Shumica e vëzhguesve, duke përfshirë edhe Agim Çekun, mendojnë që numri i luftëtarëve ka qenë rreth 20.000. Sidoqoftë IOM (Organizata Ndërkombëtare për Emigracionin), mori 25.723 kërkesa për asistencë riintegrimi, kur ajo filloi të regjistronte luftëtarët e UÇK më vonë gjatë vitit 1999. A. Heinemann-Grüder A dhe W-C Paes, “Qeni tund bishtin: Mobilizimi dhe Çmobilizimi i UÇK” (BIIC, Bonn, 2001), fq. 14. Nuk është e qartë nëse shifra prej 20.000 përfshin edhe 600–4.000 luftëtarët e FARK, shumica e të cilëve luftonin me stemën e UÇK.

²³⁰ 32.000 rezultojnë nga aplikimi i “shumëzuesit rebel” të “Studimit konservator për Armët e Vogla” prej 1.6 armësh për çdo luftëtar me shifrën 20.000 luftëtarë. “A. Khakee, N. Florquin, “Kosova dhe Armët: Një vlerësim i kufizuar i AVAL në Kosovë”, (Gjenevë, Studimi për AV/PNUD, qershor 2003), fq. 13. Por krahaso: “Llogaritjet e numrit të armëve të disponueshme ndryshojnë shumë. Ndërsa REUTER [...] jep shifrën prej 100.000 armësh, të tjerët argumentojnë që arsenalin e UÇK “ishte i varfër dhe i pamjaftueshëm” [...] Qëndrimi i dytë mbështetet nga tregimet e ish-luftëtarëve dhe nga Gjenerali Agim Çeku, shefi i shtabit të UÇK që prej majit të vitit 1999. A. Heinemann-Grüder A dhe W-C Paes, “Qeni tund bishtin: Mobilizimi dhe Çmobilizimi i UÇK” (BIIC, Bonn, 2001), fq. 13. duke cituar :Reuter, Jens “Zur Geschichte der UCK” në Reuter, Jens dhe Clewing, Konrad eds, *Der Kosovo Konflikt – Ursachen, Verlauf, Perspektiven*, (Klagenfurt, Wieser Verlag, 2000) p. 172; Troebst, zyrtarë të pushtetit vendor “Lufta e Kosovës, Raundi I parë: 1998”, *Sudosteuropa*, vëllimi 48, nr 3/4, fq.156–190, p.167; Kusovac, Zoran, “Intervistë me Gjeneralin Agim Çeku”, *Jane’s Defence Weekly*, 20 tetor 1999.

²³¹ S. Grillot, S. Stoneman, H. Risser and W-C Paes “Paqe e brishtë: Armët dhe Siguria në Maqedoninë e pas-konfliktit”, (SEESAC/SAS/BICC, Beograd, 2004), fq. 21, duke cituar Zoran Kusovac, “Sa armë janë në Maqedoni” *Jane’s Defence Weekly*, 29 gusht 2001. Ndajja e përgjithshme të llojeve të armëve është: pushkë 5.000–8.000; mitrolozë të rëndë (shumica e kalibrit 50) 150–250; snajpera (duke përfshirë disa të kalibrit 50) 100–200; MANPAD-e 20–50; hedhës anti-tank 200–350; topa (60, 80, 120 mm) 100–200, mina anti-tank dhe anti-njeri 5.000+.

²³² S. Grillot, S. Stoneman, H. Risser and W-C Paes “Paqe e brishtë: Armët dhe Siguria në Maqedoninë e pas-konfliktit”, (SEESAC/SAS/BICC, Beograd, 2004), fq. 24,

²³³ “Disa nga armët e UÇK-së pa dyshim që u transferuan tek UÇPMB-ja (një fraksion i UÇK-së që luftonte kundër policisë serbe në Serbinë e Jugut), e cila kishte afërsisht 2.200 antarë në vitin 2000, 46 kur luftimet në Serbinë e Jugut arritën kulmin. Sot, numri i luftëtarëve të saj ka të ngjarë të jetë pak më i vogël, ndoshta rreth 1.000 (prandaj edhe arsenalin e saj llogaritet tek 1.600–2.000 armë) A. Khakee, N. Florquin, “Kosova dhe Armët: Një vlerësim i kufizuar i AVAL në Kosovë”, (Gjenevë, Studimi për AV/PNUD, qershor 2003), fq. 15.

²³⁴ A. Khakee, N. Florquin, “Kosova dhe Armët: Një vlerësim i kufizuar i AVAL në Kosovë”, (Gjenevë, Studimi për AV/PNUD, qershor 2003), fq. 15.

²³⁵ Vlerësimi i UNHCR-së dhe njësia e analizave të politikave, “Kriza e refugjatëve kosovarë: Vlerësim i pavarur i përgatitjes dhe përgjigjes urgjente të UNHCR-së”, shkurt 2005, fq. 117.

²³⁶ Intervistë: Përfaqësuesi OJF-së kosovare, 26 tetor 2005.

nga Shqipëria gjatë 18 muajve²³⁷ të mëparshëm. Artikulli gjithashtu sugjeroi se Ministri i atëhershëm i Rendit, Ceka, kishte llogaritur se rreth 100,000 armë të vogla dhe të lehta ishin trafikuar në Greqi nga Shqipëria që prej grabitjeve të vitit 1997, me ndoshta mijra prej tyre të destinuara për vëndet e treta. Grumbullime në masë të armëve janë zbuluar gjithashtu kohët e fundit, të fshehura në shpella përgjatë kufirit shqiptaro-grek.²³⁸ Janë bërë gjithashtu një sërë përgjimesh të armëve të vogla dhe të lehta të trafikuar në pikën e kalimit kufitar me Greqinë dhe metodat e përdorura për trafikimin e armëve përgjatë kufirit grek mendohen të jenë të ngjashme me ato të përdorura në veri dhe lindje.²³⁹ 2,100 armë u konfiskuan nga policia greke në periudhën 18 mujore deri në korrik të vitit 1999.²⁴⁰ Në vitin 1999 policia greke konfiskoi një total prej 1,242 armësh pa leje, ndërsa në vitin 2000 shifra ishte 1,243.²⁴¹ Meqënëse në 1995, e njëjta shifër ishte vetëm 680 dhe disi më e vogël në 1990,²⁴² dhe duke konsideruar atributimin e ndryshimit prej 550 në vit për të rritur furnizimin nga Shqipëria nga stoqet e grabitura të vitit 1997 nga Shqipëria, mund të planifikohet se duke supozuar që ishte zbuluar²⁴³ vetëm një në dhjetë armë të trafikuar, një mesatare prej 5,500 armësh hyri në Greqi në vit nga viti 1997 derisa ky aktivitet ra, pasi furnizimet u pakësuan ose për shkak se qeveria greke forcoi sigurinë e kufijve në vitin 2002.²⁴⁴ Meqë vitet 1999 dhe 2000 janë vitet e mesit të periudhës në të cilën trafikimi do të ishte pakësuar gradualisht nga pika kulmore në vitin 1997, ky total shumëfishohet nga 7 vite deri në dhe duke përfshirë vitin 2002, për të dhënë shifrën 38,500 si llogaritje të armëve të vogla dhe armatimeve të lehta të trafikuar në Greqi që prej vitit 1997. Megjithatë kjo shifër është e pasaktë, meqë nuk ka bazë të besueshme për projektimin e numrit të trafikuar në një periudhë më të gjatë nga konfiskimet në vitet teke, përsëri preferohet të mos sigurojmë asnjë llogaritje të këtyre shifrave.

Një llogari e shpërndarjes aktuale të armëve të vogla dhe të lehta në vënd nënkupton që armët mund të kenë vazhduar të hyjnë në Shqipëri që prej vitit 1997. Siç është deklaruar, është e besueshme të sugjerojmë se grupet rebele etnike të Shqipërisë mund të kenë kthyer armë brënda kufijve shqiptarë për të shmangur zbulimin dhe konfiskimin e tyre në Kosovë, Maqedoni ose Serbinë Jugore, megjithatë nuk ka asnjë llogaritje konkrete të sasisë.²⁴⁵ Ekspertët lokalë argumentonin se armët shqiptare të grabitura janë të një cilësie të dobët dhe me përdorim të kufizuar për shumë organizata terroriste/kriminale. Megjithatë, u deklarua se nëse tensionet në Europën Juglindore rriten, atëherë armët në shkallë të gjërë që trafikohen nga Shqipëria mund të bëhen shqetësim kryesor, pasi armët e grabitura ishin objekt konfliktesh në rajon.²⁴⁶ Sasi të mëdha të armëve mund të fshihen në shumë depo të vogla përgjatë kufirit lindor të Shqipërisë.²⁴⁷ Po ashtu besohet të supozojmë se luftëtarët vullnetarë nga veriu i Shqipërisë mund të jenë kthyer më pas në Shqipëri, duke sjellë edhe armët me vete. BICC i referohet këtyre luftëtarëve në qindra vetë sesa mijra, që mund të sugjeronte një shifër maksimale prej 1,000.²⁴⁸ armësh të kthyer nga këta individë.

237 '150,000 armë shqiptare besohen të jenë në Greqi', Athinë Elevationistipia në greqisht, 24 korrik 1999, fq 3. Burimi: NISAT Black Market Archive Database, <<http://www.nisat.org/>>, 17 maj 2005.

238 'arsenali i armëve të rënda gjetur në shpellën në kufirin grek', Cështje të Krimit dhe Korrupsionit në Shqipëri, 5–11 mars 2005.

239 Për shëmbull, shih: 'policia greke gjen, konfiskon 300 Kallashnikovë', Athens Neës Agency, në anglisht, 1815 GMT, 20 shkurt 1998, <<http://www.ana.gr>>. Burimi: NISAT Black Market Archive Database, <<http://www.nisat.org/>>, 17 Maj 2005.

240 '150,000 armë shqiptare besohen të jenë në Greqi', Athens Elevationistipia in Greek, 24 korrik 1999, fq 3. Burimi: NISAT Black Market Archive Database, <<http://www.nisat.org/>>, 17 maj 2005

241 'Detaje të raportit për rritjen e qarkullimit të armëve pa leje në Greqi', *Athens To Vima*, [në greqisht], 19 prill 2001.

242 Sombolos Y, '2.5 miliardë dhrahmi xhiro vjetore nga trafikimi i armëve' *Imerisia* [në greqisht] 22 dhjetor 2001.

243 Llogaritje të kujdesshme bazuar në një intervistë me: Sojati, 26 tetor 2005.

244 Komisioni Europian, 'Raporti i Tretë Vjetor mbi zbatimin e Planit të Përbashkët të Bashkimit Europian i datës 12 korrik 2002 mbi kontributin e Bashkimit Europian për luftën e grumbullimit destabilizues dhe përhapjen e armëve të vogla dhe armatimeve të lehta (2002/589/CFSP)' (2003/C 312/01), *Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian*, 22 dhjetor 2003, http://www.smallarmssurvey.org/source_documents/Regional%20fora/European%20Union/EUJointAction%20Report%202003.pdf, fq 4.

245 Diskutuar si hipotezë e besueshme në: Khakee A, Florquin, N, 'Kosova dhe armët: Një vlerësim bazë i armëve të vogla dhe armatimeve të lehta në Kosovë', (Gjenevë, Studimi i armëve të vogla/PNUD, qershor 2003), fq. 14 (duke iu referuar vëndeve të mundshme masive të magazinimit në Bucaj dhe Krumë); Heinemann-Grüder A and Paes E-C, 'Wag the Dog: Mobilizimi dhe ç'mobilizimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës', BICC brief 20, (BICC, Bonn, 2001), fq.22; Ripley, Tim, 'Arsenali i UCK', *Jane's Intelligence Review*, nëntor 2000. Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 21 prill 2005.


246 Intervista, zyrtar i Ministrisë së Rendit, 25 prill 2005.

247 Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 21 prill 2005; Heinemann-Grüder A and Paes W-C, 'Wag the Dog: Mobilizimi dhe ç'mobilizimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës' (BICC, 2001), fq. 20–1; op cit Grupi i Krizës Ndërkombëtare, 2003, fq. 10.

248 Heinemann-Grüder A dhe Paes E-C, 'Wag the Dog: Mobilizimi dhe ç'mobilizimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës' BICC brief 20, (BICC, Bonn, 2001), fq. 14

Për sa i përket armëve që hynë në qarkullim pa leje në Shqipëri, pas importit nga individë ose banda të krimit të organizuar, faktet sugjerojnë se këto transfera kanë qënë të kufizuara në numra të ulët të armëve me specifikim të lartë. Një i intervistuar nga Ministria e Rendit deklaroi se shumë prej atyre që u arrestuan për mbajtje pa leje të armëve të vogla dhe të lehta, aktualisht kanë tendencën të kenë armë të trafikuar kohët e fundit nga jashtë shtetit më tepër sesa stoqet e vjetra shqiptare.²⁴⁹ Kjo çon në hipotezën se midis vëllazërisë kriminale shqiptare ka një tregti të vazhdueshme të armëve të specifikimit të lartë, më të madhe sesa janë përgjithësisht në ofertë brënda vëndit. Statistikat nga Iniciativa e Bashkëpunimit me Europën Juglindore mbi konfiskimet nga policia shqiptare gjatë periudhës nëntor 2002 deri në dhjetor 2003, tregojnë nivelet e ulëta të aktivitetit të trafikimit, të tilla që nuk do të ndryshonin dukshëm projektimet e armëve pa leje në vënd. Siç tregon grafiku, armët e konfiskuara me tyta më të gjata ka të ngjarë që në shumicën e rasteve të jenë shqiptare, ndërsa një sasi e madhe e armëve të dorës e kishin burimin nga jashtë vëndit.²⁵⁰ Nga këto, tre njiheshin të ishin trafikuar: një Beretta, që erdhi nga Italia në nëntor të vitit 2002; një Zastava, e cila hyri në vënd nga Mali i Zi; dhe një pistoletë e vogël që erdhi nga Zvicra në Maqedoni në dhjetor të vitit 2002. Numrat e ulët të konfiskimeve, veçanërisht konfiskimet e trafikimit sugjerojnë nivelet e ulëta të kontrollit ose të trafikimit-ndoshta edhe të dyja.

Sekuestrimet e armëve në Shqipëri të raportuara nga SECI (Nëntor 2002–Maj 2003)



Sipas shefit të sektorit për trafikimin e paligjshëm, Z. Edmond Bahiti, prania në rritje dhe e përmirësuar e policisë, ndryshimet në strukturat organizative, prezantimi i neneve specifike mbi trafikimin në Kodin Penal dhe situata e përmirësuar ekonomike në Shqipëri kanë ndihmuar në uljen e volumit të trafikimit nga, në dhe nëpërmjet Shqipërisë. Sipas tij, trafikimi i armëve ka rënë ndjeshëm që prej vitit 2000 dhe nga fundi i konfliktit të Kosovës. U deklarua se në një shkallë më të vogël, armë individuale dhe ngarkesa të vogla armësh mendohen të jenë trafikuar në Greqi dhe Itali nga Shqipëria. Në këto raste, armët janë menduar të destinohen për emigrantët shqiptarë, shtetas grekë ose italianë të cilët dëshirojnë armë zjarri për mbrojtjen e tyre ose për kontrabandistët e armëve, të cilët duan t'i shesin më tej ato armë.²⁵¹ Policia shqiptare dhe ajo kufitare kanë konfiskuar disa pistoleta që janë sjellë në Shqipëri gjatë viteve të fundit, me një mesatare nga dhjetë deri në dymbëdhjetë pistoleta të konfiskuara çdo muaj në vitin 2005. Midis përgjithësisht të armëve të konfiskuara të këtij viti, kanë qënë Beretta, armë dore Browning dhe Colt dhe pistoleta të tipit TT të prodhuara në Jugosllavi. Në këto rastet e fundit, Shqipëria është një rrugë tranziti më tepër sesa

²⁴⁹ Intervista, zyrtar i Ministrisë së Rendit, 26 prill 2005.

²⁵⁰ Task Force i Iniciativës së Bashkëpunimit të Europës Juglindore, Në luftë kundër trafikimit të armëve të vogla, armatimeve të lehta dhe eksplozivëve, "Raport analitik – Operacionet Ploughshares" (maj 2003).

²⁵¹ Intervista, zyrtar i Ministrisë së Rendit, 20 prill 2005; op cit Smith dhe Sagramoso, fq. 25

furnitore.²⁵² Megjithatë, sipas burimeve të Ministrisë së Brëndshme, nga 777 raste të trafikimit të pazbuluar në kufi në vitin 2004, vetëm tre kanë të bëjnë me trafikimin e armëve. Kështu, duhet të supozohet se shumica e pistoletave të prodhuara jashtë shtetit janë konfiskuar gjatë operacioneve të tjera policore.

Trafikimi i armëve në Itali nëpërmjet detit Adriatik nga Shqipëria që prej vitit 1997 nuk është menduar të jetë përhapur dhe shifra neto do të reflektonte gjithashtu se armët italiane duhet të kenë përfunduar në duart e kriminelëve në Shqipëri në sasi të vogël gjatë të njëjtës periudhë. Sipas raporteve, trafikimi i armëve nga Shqipëria nuk u konsiderua si prioritet kryesor për autoritetet policore italiane në fund të viteve 90, me prova të kufizuara që sugjeronin se çdo javë rreth 20 armë të vogla dhe armatime të lehta (AVL) kalonin në ngushticat nga lindja në perëndim.²⁵³ Përgjithësisht, armët ishin konfiskuar në sasira të kufizuara kur trafikuesit e drogës u kapën në kufijtë tokësorë ose kur tentonin të kalonin nga deti, me armët që besoheshin të ishin për vetëmbrojtje ose si “dhurata” për marrësit.²⁵⁴ Për më tepër, shumica e armëve që janë trafikuar nga Shqipëria, të zbuluara nga punonjësit e doganës dhe ata policorë në Greqi dhe Itali nuk janë me origjinë kineze ose shqiptare, por kryesisht janë me origjinë jugosllave.²⁵⁵

Për qëllimet tona, në llogaritjen e trafikimit neto që prej vitit 1997, prova e armëve që kanë hyrë në vënd në një shkallë të vogël e ka bërë ekipin studimor të planifikojë një ekuilibër midis numrit të armëve të nisura në Itali dhe destinacioneve të ndryshme nga Greqia, Kosova, Maqedonia dhe Serbia Veriore, me ato armë që mund të kenë hyrë në vënd për një sërë arsyes të reflektuara që prej vitit 1997. Pranohet se ky planifikim është bërë, bazuar në mungesën e provave për të kundërtën. Si përfundim, nëse supozohet se trafikime të tjera për end- userat globalë që prej vitit 1997 nga stoqet civile nuk i tejkaluan armët që hyjnë në Shqipëri dhe armëmbajtjet e paligjshme para vitit 1997, llogaritja përfundimtare e trafikimit neto që prej vitit 1997 është që rreth 117,875 armë kanë lënë vëndin.

Shëmbuj të trafikimit të kohëve të fundit në Shqipëri

Në dhjetor të vitit 2004, tre raketa tokë- ajër u konfiskuan nga autoritetet shqiptare, me trafikuesit e dyshuar të kapur falë një ndryshimi në ligj, që lejonte mbledhjen e provave gjatë përgjimit dhe regjistrimit të telefonatave të të dyshuarve, për t'u përdorur në gjyq. Të intervistuarit nuk ishin në gjendje të jepnin detaje konkrete mbi end-userat²⁵⁶ e dyshuar, megjithëse media spekuloi se ata ishin të destinuar për në Maqedoni.²⁵⁷ Një raport sugjeroi se grupet ekstremiste shqiptare në Maqedoni kishin kërkuar në mënyrë aktive Sistemet e Mbrojtjes Ajrore Të Transportueshme nga Njeriu, nga disa burime në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2004.²⁵⁸ Megjithatë, autoritetet shqiptare ishin mjaft të bindura se kontrabandistët shqiptarë i kishin blerë raketat nga malezezët, dhe origjina e raketave që mendohej të ishte Bosnja ose Serbia. Është debatuar se kjo mënyrë për kontrabandën e armëve në Shqipëri u prezantua fillimisht në vitin 1991, me sasi të variueshme armësh që kalonin përmes kufirit.²⁵⁹

Në mars të vitit 2005, një operacion goditës rezultoi në konfiskimin e gjashtë aparateve eksplozivësh me detonim në distancë, të projektuara që të aktivizoheshin nga telefona celularë. Përsëri, kontrabandistët shqiptarë të armëve kishin blerë eksplozivët e tyre të paligjshëm nga Mali

²⁵² Intervista, zyrtar i Ministrisë së Rëndit, 20 prill 2005; zyrtar ndërkombëtar, 21 prill 2005; op cit Smith dhe Sagramoso, fq. 27–8.

²⁵³ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 19 Prill 2005. shih gjithashtu: op cit Smith and Sagramoso, fq. 28.

²⁵⁴ Interview, zyrtar ndërkombëtar, 19 Prill 2005. shih gjithashtu: 'Kapet emigranti duke trafikuar heroinë në Greqi', Cështje të kimit dhe korrupsionit në Shqipëri, 18–24 dhjetor 2004; 'Policia greke arreston kontrabandistët shqiptarë, konfiskon droga', Athens News Agency, në anglisht 1334 GMT, 11 Prill 1998, <http://www.ana.gr>; 'Policia arreston 90 kriminelë për trafik droge dhe armësh', AP, 9 qershor 1998; 'Itali: Armët, droga e konfiskuar në portin e Barit', FBIS-EEU-2000-0316, Rome ANSA (version i bazës së të dhënave Ansaservice), në italisht, 1138 GMT, 16 March 2000 [FBIS teksti i përkthyer]. Burimi: Baza e të dhënave të arkivit të Tregut të Zi NISAT, <http://www.nisat.org/>, 17 maj 2005.

²⁵⁵ Op cit Smith dhe Sagramoso, fq. 27–8.

²⁵⁶ Intervista, zyrtar i Ministrisë së Rëndit, 20 Prill 2005; zyrtar i Ministrisë së Rëndit, 20 Prill 2005; zyrtar i Ministrisë së Rëndit, 20 Prill 2005.

²⁵⁷ 'Ministria e Brëndshme: raketat ajër- tokë të kapura në Shqipëri nuk kanë destinacion Maqedoninë, <http://www.realitymacedonia.org.mk/ëeb/neës_page.asp?nid=3999>, MIA – Agjencia e informacionit maqedonase, 14 dhjetor 2004; Mahmutaj F, 'Përgjimi i burgut zbulon shitësit', Gazeta Shqiptare, 18 dhjetor 2004. Burimi: faqja e internetit të Qendrës për Studime të Europës Juglindore, <http://www.csees.net>, 7 prill 2005.

²⁵⁸ Op cit Barnett, 2004.


²⁵⁹ 'Prokurorët shqiptarë thonë se bosat e kontrabandës së armëve janë në Mal të Zi', 2 mars 2005, Monitorimi i BBC; 'Armët për Kosovën-Metohija nëpërmjet Podgoricës', Blic, në serbisht, 28 tetor 2002. Burimi: faqja e internetit të Qendrës për Studime të Europës Juglindore, <http://www.csees.net>, 7 Prill 2005.

i Zi.²⁶⁰ Të intervistuarit ishin të lumtur të deklaronin se ky operacion ishte kryer me sukses, falë legjislacionit të ri mbi luftën kundër krimin të organizuar dhe trafikimit, si dhe bashkëpunimit të mirë me homologët në Mal të Zi. Mbetet për t'u parë nëse këto janë thjesht shembuj të izoluar në përdorimin e vazhdueshëm të armëve malazezo-shqiptare dhe kanalit të trafikimit të pajisjeve ushtarake ose nëse përfaqësojnë ndonjë shenjë paralajmërimi të pengimit të rritjes së aktiviteteve të ANA ose NLA në Maqedoni ose diku tjetër

3.4.1 Perceptimi i trafikimit

Është interesante të vërehet se shumica e pjesëmarrësve të anketimit menduan se trafikimi i armëve pa leje është ende një problem për Shqipërinë, me pothuajse një të tretën e pjesëmarrësve që sugjeronin se mbetet ende një problem serioz.

Në ç'masë është shqetësues trafiku i paligjshëm i armëve në...



Megjithatë vetëm 4.4 për qind e pjesëmarrësve deklaruan se ata mendonin se trafikimi i armëve pa leje nuk është problem për Shqipërinë, shtatëfishi i tyre mendonin se nuk ishte problem në komunitetin e tyre lokal. Në Tiranë, 39 për qind e pjesëmarrësve deklaruan se trafikimi i armëve është një problem për Shqipërinë, por vetëm 7.5 për qind menduan të njëjtën gjë për komunitetin e tyre, me 32 për qind të pjesëmarrësve që deklaruan se aty nuk ishte një problem. Krahasimisht, në pjesën veriore të Shqipërisë, vetëm 29 për qind e pjesëmarrësve e panë atë si problem serioz për Shqipërinë. Megjithatë, ky rajon kishte numrin më të madh të pjesëmarrësve që deklaruan se ishte një problem i rëndë për komunitetin e tyre (13 për qind) dhe gjithashtu numrin më të madh të pjesëmarrësve që deklaruan se nuk ishte aspak problem (35 për qind). Përgjigje të ngjashme u dhanë edhe në intervistat e zhvilluara me zyrtarë në rajonet përgjegjëse për studimin e rastit, pasi ata shpjeguan se trafiku i armëve nuk konsiderohej si problem serioz për rajonin e tyre.

3.5 Mbajtja e armëve të vogla dhe të lehta nga civilët

3.5.1 Mbajtja e armëve me leje nga civilët

Shifra prej 65,747 për numrin total të armëve të vogla dhe armatimeve të lehta të regjistruara nga civilët në Shqipëri është marrë nga Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe Armatimeve të Lehta.²⁶¹ Dokumenti jep analizën statistikore të mëposhtme për armët e vogla dhe armatimet e lehta të regjistruara nga civilët:

²⁶⁰ Intervista, zyrtari i Ministrisë së Rendit, 20 Prill 2005; zyrtari i Ministrisë së Rendit, 20 Prill 2005.

²⁶¹ Op cit Draftin e Strategjisë Kombëtare mbi Armët e Vogla dhe Armatimet e Lehta.

Tabela 14: Mbajtja e armëve të vogla dhe të lehta të regjistruara nga civilët

Lloji i AVL	No i njësive
Pistoleta	2,585
Pushkë automatike	331
Pushkë	230
Pushkë gjahu (një dhe dy grykëshe)	62,472
Armë të nxjerra me licensë nga Garda e Republikës	130
Totali	65,747

Megjithatë, kjo shifër nuk përputhet plotësisht me shifrat e përfutuara nga intervistat. Për shëmbull, midis viteve 1997 dhe 2002, biznesmenëvet me kapital të konsiderueshëm dhe banorëve të zonave kufitare u lejoheshin të regjistronin pistoleta dhe armë të tjera për të mbrojtur veten, personat dhe pasurinë, në përputhje me Ligjin No. 8388 'Mbi armët e vogla dhe të lehta', të datës 25 gusht 1998. Sipas një anëtarit të skuadrës së grumbullimit të armëve të Ministrisë së Brendshme, rreth 500 armë u regjistruan në përputhje me këtë ligj,²⁶² ndërsa dokumenti i draftit të Strategjisë Kombëtare të Armëve të Vogla dhe të Lehta, jep një shifër prej vetëm 306 (268 pistoleta, 23 pushkë automatike dhe 15 pushkë).²⁶³

3.5.2 Armët e mbajtura pa leje

Armëmbajtja pa leje është një fushë sensitive ku rrallë ofrohet informacion konkret. Është e vështirë të bëhen llogaritje të sakta për Shqipërinë, pasi përfaqësimet e përdorura në kontekste të tjera (si sasia e vetëvrasjeve ose vrasjeve të përgjithshme që janë kryer me anë të një arme zjarri) nuk kanë qenë në dispozicion të ekipit studimor, për shkak të mungesës së statistikave përkatëse për vëndin. Nuk ka as përfaqësime të tilla që kanë të ngjarë të jenë të transferueshme midis mjediseve kulturore.²⁶⁴

Kur bëhen llogaritjet e para mbi këtë çështje, një konsiderim fillestar është që derisa ligjit të amnistisë i mbaroi afati në fund të majit 2005, një mesatare prej 800–1,000 armësh në muaj dorëzoheshin vullnetarisht nga civilët në Shqipëri, pa angazhim të qëndrueshëm në ndonjë iniciativë grumbullimi të profilit të lartë.²⁶⁵ Megjithëse kjo nuk përfaqëson bazën për llogaritjen e sasisë egzakto, kjo nënvizon faktin se mbetet një volum i madh armësh të vogla e të lehta pa leje në duart e civilëve.

Llogaritja zyrtare më e përdorshme e armëmbajtjes pa leje është 176,857, ndërsa llogaritja më e besueshme e nxjerrë nga ekipi studimor sugjeron që ka të paktën 208,982 armë të vogla dhe të lehta pa leje në qarkullim në Shqipëri, megjithëse kjo shifër nuk paraqitet si përfundimtare. Dy llogaritje të mëtejshme, bazuar në përgjigjet e studimit të brendshëm, sugjerojnë nivele të amëmbajtjes pa leje në 156,452–241,678 dhe 70,969–208,466. Fakti që llogaritjet e familjeve të bazuara në studim janë më të ulta sesa llogaritja e ekipit kërkimor mund të tregojë se shifra e zotëruar nga familjet ose individët nuk konsiderohet për të gjitha armët pa leje në qarkullim, me pjesën që mbetet ndoshta të mbajtur në masë nga kriminelët, trafikantët ose rebelët. Llogaritjet janë treguar në grafikun e mëposhtëm.


²⁶² Intervista, zyrtar i Ministrisë së Rendit, 15 prill 2005.

²⁶³ Op cit Draftin e Strategjisë Kombëtare mbi Armët e Vogla dhe Armatimet e Lehta.

²⁶⁴ Cf Taylor Z, Philips, C dhe Bogosavljevic, S, 'Jetesha me trashëgimi – Studim i AVL, Republika e Serbisë', (Beograd, UNDP/Saferworld, prill 2005), fq.15.

²⁶⁵ Ministria e Rendit raportoi grumbullimin e 11,307 armëve në vitin 2005. Shih Rynn S et al, Monitorimi i armëve të vogla dhe armatimeve të lehta në Europën Juglindore 2005, (Saferworld/SEESAC, 2005), fq.26.

Vlerësimet për armëmbajtje pa leje



Shënim re: pikat e mesme janë vendosur aty ku vlerësimi është midis pragjeve më të lartë dhe më të ulët.

Shifrat në grafik nuk janë përfundimtare dhe janë objekt i marzhinave me gabime, por janë siguruar me konsiderim të kujdesshëm të faktorëve kontingjentë dhe provave të paraqitura më poshtë. Është paraqitur metodologjia që gjendet poshtë çdo shifre, si dhe pikat e forta e të dobëta të shqyrtuara në seksionin e mëposhtëm. Megjithatë çdo shifër është objekt i dobësive, të marra së bashku, është e mundur të zhvillohet një shkallë sigurie rreth shifrës së 200,000 armëve pa leje, me një pjesë të këtij numri që ka të ngjarë të mbahet në masë nga kriminelët më tepër sesa nga familjet ose individët.

Tabela 15: Llogaritjet e ndryshme të numrave të armëve të vogla dhe të lehta pa leje në Shqipëri

QARKULLIMI PA LEJE

Metoda	Problemet kryesore	Llogaritja
1. Shifra zyrtare	Nuk merret parasysh armëmbajtja para vitit 1997; Mbivlerësime të armëve të trafikuarat	176,857
2. Armët e grabitura minus ato të grumbulluara dhe të trafikuarat	Nuk merret parasysh armëmbajtja para vitit 1997; Asnjë mjet për të llogaritur në mënyrë përfundimtare trafikimin e të gjithë marrësve; Nuk konsiderohen armët e kthyera/të futura në Shqipëri; Mbështetet mbi supozimet rreth armëmbajtjeve të rebelëve	208,982

ARMËMBAJTJA PA LEJE NE SHTEPI

Metoda	Problemet kryesore	Llogaritja
3. Studimi i familjeve		
Pyetja 1 – ‘Sa për qind e familjeve në shoqërinë shqiptare kanë të paktën një armë zjarri funksionale?’ iu drejtua një totali HH me koeficientin e armëve të përdorura për familje	Dyshimet mbi mundësinë e publikut për të llogaritur saktësisht në rrafsh kombëtar nivelin e armëmbajtjes; Bazë e dyshimtë për projektimin e armëve për familje	156,452–241,678
Pyetja 2 – ‘A keni patur ndonjëherë armë në shtëpi?’ iu drejtua një totali HH me koeficient armësh për familje minus armët e grumbulluara	Totali i armëve që janë mbajtur pa leje i tejkalon zbulimet e studimit	70,969–208,466
Pyetja 3 – ‘A keni aktualisht ndonjë armë në shtëpi?’ iu drejtua një totali familjesh me armë për koeficientin e familjeve	Raportim më i ulët midis pjesëmarrësve; Shkalla e grumbullimit të armëve në maj 2005 dhe numrat minimalë të armëve të grabitura në qarkullim e zhvlerësojnë këtë shifër	26,425–61,664

Llogaritja zyrtare

Llogaritja e cituar më e përhapur për AVL pa leje në duart e civilëve në Shqipëri është 200,000, një shifër e arritur nga përdorimi i një totali të përmbledhur prej 550,000 AVL të grabitura dhe zbritjen e 200,000 AVL të grumbulluara dhe 150,000 AVL të llogaritura si të trafikuar. Ky total mund të bëhet më i saktë duke zbritur shifrën më të fundit në dispozicion të armëve të grumbulluara (222,918 i qershorit 2005) dhe 150,000 armëve të trafikuar nga shifra zyrtare e armëve të grabitura (549,775), duke rezultuar kështu në një total prej 176,857 armësh zjarri pa leje. Disa nga armët e grabitura ka të ngjarë të jenë legalizuar, pasi ligji asnjëherë nuk ka parashikuar pronësinë e armatimeve të tipit ushtarak.

Tabela 16: Llogaritja zyrtare e numrit të AVL pa leje në Shqipëri**Metoda 1: Shifra zyrtare**

Armët e grabitura	549,775
– Armët e grumbulluara	– 222,918
– Armët e trafikuar	– 150,000
= Total	176,857

Përpunimi i totalit të përfshirë nga sasia e armëve të grabitura

Ka disa probleme me shifrën zyrtare. Kësaj shifre duhet t'i shtohet numri i armëve pa leje në duart e civilëve para vitit 1997. Ka disa të dhëna sesa armë të tilla egzistonin, por numri mund të ketë qënë i ulët për shkak të kontroleve shtypëse sociale të zbatuara nën urdhrat e Hoxhës. Një burim tjetër i mundshëm për armët e grumbulluara mund të ishin armët që janë mbajtur pa leje që prej Luftës së Dytë Botërore ose edhe më përpara. Megjithatë është pretenduar se ushtarakët shqiptarë kishin një numër të madh armësh trofe në magazinat e tyre,²⁶⁶ ka shumë të ngjarë që numri i armëve të grumbulluara të periudhës LBII ose edhe më herët të jetë më i madh sesa numri i armëve mbajtur në magazinat ushtarake shqiptare para vitit 1997. Në të vërtetë, është debatuar se disa nga armët që janë dorëzuar vullnetarisht po dorëzohen aktualisht në mënyrë vullnetare, sepse armët e grabitura në vitin 1997 kanë zëvendësuar modelet që ishin më të vjetra, të cilat mbaheshin pa leje për shumë vite.²⁶⁷ Fakti që cilësia e armëve të grumbulluara varionte me kohë, duke filluar me ato të papërdorshmet dhe të ndryshkurat dhe duke përfunduar me njësitë e cilësisë së lartë do të dukej ta mbështeste këtë.²⁶⁸ Duke patur këtë parasysh, është e qartë se numri i panjohur i armëve të mbajtur pa leje nga civilët para grabitjeve të vitit 1997, nëse dihet, mund t'i shtohet ndjeshëm totalit të përfshirë nga numri i armëve të grabitura në 1997.

Tabela 17: Numri i llogaritur i AVL pa leje në Shqipëri, bazuar në përdorimin e statistikave për grabitjet e vitit 1997 dhe trafikimin e mëtejshëm**Metoda 2: Zbritja nga stoqet e grabitura**

Armë të grabitura	549,775
– Armë të grumbulluara	– 222,918
– Armë në KLA/NLA/UCPMB	– 40,000
– Armë në Greqi	– 38,500
– Armë të refugjatëve	– 39,375
+ armë para vitit 1997	+ ?
+ Armë të tjera hyjnë/largohen nga Shqipëria (neto)	0
= Total	208,982

Një problem tjetër me shifrën zyrtare është se numri i armëve të grumbulluara që zakonisht është zbritur nga totali i vjedhur në vitin 1997 përfshin tytat dhe armët,

²⁶⁶ Disa të intervistuar të përfshirë në programet e mëparshme të grumbullimit ishin të sigurt se shumë prej armëve të dorëzuara nuk ishin në fakt nga stoqet e grabitura, por nga periudha komuniste – njerëzit zëvendësuan stoqet e tyre të vjetra. Intervista, ish zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 18 prill 2005 dhe zyrtari i Ministrisë së Rendit, 15 prill 2005.

²⁶⁷ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 29 prill 2005; zyrtar i Ministrisë së Rendit 15 prill 2005.

²⁶⁸ Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 12 prill 2005.

pjesët e të cilave nuk përbëjnë njësi tërësisht operacionale të AVL (shih seksionin 6.4 'Rezultatet e amnistisë për proceset e grumbullimit të armëve'). Kështu, totali i armëve të grumbulluara mund të jetë tejte i ekzagjeruar. Megjithatë, problemi i mëtejshëm kyç me shifrën zyrtare është se ai varet nga një llogaritje e debatueshme e njësive neto të trafikuara brënda/jashtë vëndit që prej vitit 1997. Ky studim ka përpiluar një llogaritje të rishikuar të trafikimit që prej vitit 1997 siç skicohet më poshtë në seksionin 3.4 – 'Llogaritjet e AVL të trafikuara'. Nëse kjo llogaritje e rishikuar 117,875 të trafikuara jashtë Shqipërisë që prej vitit 1997 zëvendëson llogaritjen e mëparshme prej 100,000–150,000 AVL, ekipi studimor llogarit në mënyrë të kujdesshme se rreth 208,982 AVL mbeten në qarkullim pa leje në Shqipëri.

Një notë përfundimtare shqetësimi duhet bashkangjitur në lidhje me këtë metodë llogaritje të armëmbajtjes pa leje; disa nga armët e grabitura në vitin 1997 do të kenë dalë jashtë përdorimit që prej hyrjes në qarkullim pa leje, në varësi të kushteve në të cilat ato janë magazinuar.

Llogaritja e armëmbajtjes në brenda vëndit sipas studimit përkatës

Studimi i brendshëm i kryer për këtë raport kërkimor siguron një metodë tjetër për të llogaritur numrin e AVAL pa leje në familjet shqiptare. Meqë ishte përdorur një teknikë e vëzhgimit rastësor, zbulimet nga studimi mund të përgjithësohen për popullsinë më të gjërë. Dy pyetje HHS krijojnë bazën për llogaritje të besueshme të niveleve të armëmbajtjes pa leje. E para prej këtyre është pyetja, 'Për mendimin tuaj, sa përqind e familjeve në shoqërinë shqiptare ka të paktën një armë zjarri funksionale?' përgjigjet e të cilave shfaqen në grafikun e mëposhtëm. Të përfaqësuara si një vijë e drejtë grafiku, pika kulmore ka arritur mbi 27%.

Sipas mendimit tuaj sa përqind e familjeve në Shqipëri kanë të paktën një armë zjarri në gjendje pune?




Tabela 18: Llogaritja e mbajtjes pa leje së AVL nëpër familje, që përdoren bazuar në pyetjen e studimit të familjeve 'Sa familje kanë armë?'

Metoda 3: HHS 1 'Sa familje kanë armë?'

27% e familjeve të llogaritura nga publiku i përgjithshëm që kanë armë	194,400	
x armë për familje	x (i ulët)	x (i lartë)
	1.143	1.58
– armët e mbajtura me leje	– 65,747	
= Totali	156,452	241,678

Ekstrapolimi i 720,000 familjeve shqiptare jep një llogaritje të 194,400 familjeve që zotërojnë aktualisht armë. Megjithatë, duhet patur mirë parasysh se disa familje kanë të ngjarë të mbajnë më shumë se një armë zjarri. Projektimi i numrit aktual të armëve

të mbajtura nga këto familje që përdorin koeficientët 1.143²⁶⁹ dhe 1.58²⁷⁰ të armëve për familje, na jep një total të llogaritur prej 222,199–307,152 armësh me leje dhe pa leje që mbahen nga civilët. Zbritja e armëve të regjistruara me leje nga ai total na jep një llogaritje të 156,452–241,678 armëve në qarkullim pa leje. Kjo shifër përputhet me rishikimin në ngritje të shifrës zyrtare të sugjeruar më sipër. Megjithatë, besueshmëria e kësaj llogaritjeje kompromentohet nga zbulimet e diskutimeve të grupit të fokusuar, në të cilat perceptimet e niveleve të armëmbajtjes së pjesëmarrësve ishin gjerësisht të papajtueshme. Kjo sugjeron se publiku nuk ka bazë të qëndrueshme për llogaritjen e nivelit të përgjithshëm në shkallë kombëtare të armëmbajtjes në familje.²⁷¹

Tabela 19: Llogaritja e mbajtjes së armëve të vogla dhe të lehta të familjeve, të përdorura bazuar në pyetjen e studimit të brendshëm 'A keni patur ndonjëherë një armë?'

Metoda 3: HHS 2 'A keni pasur ndonjëherë armë?'

43.7% e familjeve	314,640	
x armë për familje	x (i ulët)	x (i lartë)
	1.143	1.58
– Armë me leje	– 65,747	
– Armë të grumbulluara	– 222,918	
= Totali	70,969	208,466

Pyetja e dytë nga studimi i brendshëm për të ofruar bazën për një llogaritje të besueshme të armëmbajtjes pa leje është: 'A keni patur ndonjëherë armë në shtëpi?' Kjo gjeneroi një përgjigje pozitive nga 43.7 për qind e pjesëmarrësve, duke sugjeruar se 314,640 familje kishin mbajtur në një periudhë të caktuar kohore një armë zjarri. Nëse mesatarisht secili mbante 1.143–1.58 armë²⁷², kjo sugjeron se 359,633–497,131 AVAL zotërohen nga popullsia shqiptare në të gjitha kohërat. Pas zbritjes së armëve të zjarrit të regjistruara ligjërisht, pjesa që mbetet (293,887–431,384) përsëri reduktohet në minimumin e sasisë së mundshme e cila dihet të ketë qenë mbajtur pa leje në një fazë (549,775 – totali i grabitur nga viti 1997). Kjo mund të reflektojë faktin se individë ose grupe të caktuara morën pjesën e mbetur të armëve në masë. Ajo ndoshta tregon edhe detyrimin për të pohuar armëmbajtjen pa leje të armëve me karakter ushtarak në çdo fazë. Kur 222,918 armë të grumbulluara që prej vitit 1997 zbriten nga totali, pjesa që mbetet jep llogaritjen e dytë të përfutur nga studimi i familjeve i 70,969–208,466 armëve aktualisht në qarkullim pa leje në Shqipëri. Përsëri, e marrë më vete, kjo

²⁶⁹ Në përgjigje të pyetjes, 'Për mendimin tuaj, sa armë ka në një familje tipike shqiptare?' shumica e pjesëmarrësve të studimit deklaruan se ata nuk ishin në dijeni të këtij fakti. Megjithatë, një shifër mesatare për 1.143 armë për familje mund të gjenerojë nga përgjigjet e atyre që u prononcuan. Kjo është përdorur në llogaritjet që ndjekin si koeficient minimal për t'u aplikuar për numrat e llogaritur të familjeve që mbajnë armë për të projektuar totalin e armëve që ata mbajnë. Tendanca e pjesëmarrësve të studimit për të raportuar në nivel më të ulët armëmbajtjen sugjeron se koeficienti i saktë do të ishte më i lartë. Nga një bazë prej 1,200 përgjigjet ishin: 'nuk e di' – 709 (59.1%); '1' – 359 (29.9%); asnjë përgjigje – 92 (7.7%); '2' – 26 (2.2%); '3' – 7 (0.6%); '4' – 6 (0.5%); '0' – 1 (0.1%).

²⁷⁰ Nëse numri mesatar i armëve të mbajtura nga çdo familje në Shqipëri është në fakt më afër atij të vërejtur në vëndet fqinje, më tej një koeficient mjaft ose mesatarisht i besueshëm shqiptar mund të vlerësohet në 1.58. Kjo bazohet në vlerësimet për vëndet e Europës Juglindore si më poshtë: Bosnja – 1.75 (Kjo përbën koeficientin e armëve të "besimit të lartë" për familje në Bosnjë. Studimi mbi armët e vogla dhe armatimet e lehta (SAS): Bosnjë- Hercegovinë, (BICC, Bonn, 2004), fq.24); Kosovë – 1.4–1.7 (Burimi: Khakee A, Florquin, N, 'Kosovo and the Gun: A Baseline Assessment of Small Arms and Light Weapons in Kosovo', (Gjenevë, Studimi mbi Armët e Vogla/PNUD, qershor 2003), fq 2); Maqedoni – 1.61 (Nxjerrë nga përgjigjet ndaj pyetjes 'Cili është numri mesatar i armëve që njerëzit kanë në familjet e tyre?' i treguar në figurën 3.1 në Grillot S, Stoneman S, Risser H and Paes E-C, 'A Fragile Peace: Guns and Security in Post-Conflict Macedonia', (SEESAC/SAS/BICC, Beograd 2004), fq.19. Shifra e cituar është një mesatare ku 29% u përgjigjen 1, 16% u përgjigjen 2, 4% u përgjigjen deri në 3, 1% u përgjigjen 3–5 dhe 1% u përgjigjen deri në 5.); Moldavia – 1.5 (Në vitin 2004 u grumbulluan 630 armë të paregjistruara nga 389 familje në Moldavi gjatë inspektimeve që u zhvilluan nga autoritetet në një periudhë rotacioni 5 vjeçar në tërë vëndin (pa përfshirë konfiskimet e policisë nëpër rrugë). Kjo gjeneron një raport prej 1.62 armësh për familje që zotëron armë. Burimi: Departamenti i Kriminologjisë, Ministria e Brëndshme, Moldavi. [Kjo korrespondon me shifrat e armëmbajtjes nga civilët që kanë afërsisht 600,000 armë zjarri të regjistruara për rreth 400,000 familje.] Për sa i përket armëmbajtjes me leje, 44,028 individë mbajnë 49,780 armë në Moldavi, duke dhënë një raport prej 1.13 për individ të licensuar.; Mal i Zi – 1.55 (Nxjerrë nga llogaritja e një mesatareje të numrit të armëve që pretenduan të kishin pjesëmarrësit, të cilët pranuan të mbanin armë (1 armë – 19.5%, 2 – 3.3%, 3 – 1.3%, 4 – 0.7%, 5 – 1.6%): Florquin N, O'Neill Stoneman S, "A house isn't a home without a gun" Studimi i Armëve të Vogla dhe të Lehta – Republika e Malit të Zi', (SEESAC/Studimi i Armëve të Vogla, 2004), fq.49. Në lidhje me të gjitha familjet në Mal të Zi, 'nocioni i një arme zjarri për familje u shfaq në mënyrë të përsëritur gjatë shumë takimeve të zhvilluara midis Studimit të Armëve të Vogla dhe një sërë aktorësh akademikë, OJF-sh, elementësh të sigurisë private dhe aktorësh të tjerë civilë.' Ibid, fq.4); Serbia – 1.5 (shifra aplikohet për pjesëmarrësit që pranuan se mbanin armë zjarri dhe ndoshta kryesisht ka të bëjë me pronarët e ligjshëm 'Në studimin e familjeve, pjesëmarrësit u pyetën nëse ata ose një anëtar i familjes së tyre mbanin një armë zjarri dhe më pas u pyetën sesa armë zotëronin. Një total prej 20% u përgjigjen pozitivisht dhe numri mesatar i armëve të zjarrit për familje ishte 1.5.' Taylor Z, Philips, C dhe BogosAVALLjevic, S, 'Jetes me trashëgimi – Studim i AVAL, Republika e Serbisë', (Beograd, PNUD/Saferworld, prill 2005), fq.15).

²⁷¹ Cf pasiguria në rritje e pjesëmarrësve kur iu bë e njëjta pyetje rreth komunitetit të tyre lokal dhe rrethit familjar në seksionin 3.5.4, 'Perceptimet e mbajtjes së AVAL nga civilët'.

²⁷² Në fakt, koeficientët duhet të rishikohen në linjë të sipërme në lidhje me numrin e armëve të zotëruara në të gjitha kohërat (në kundërshtim të atyre që janë aktualisht në zotërim), për të marrë në konsideratë zëvendësimin e mundshëm në kohë të armëve të vjetra që ishin bërë të tepërta.

llogaritje duhet të trajtohet si pak e besueshme.

Studimi i brendshëm gjithashtu grumbulloi përgjigje për pyetjen 'A keni ndonjë armë aktualisht në shtëpi?', të cilës 11.2 për qind e pjesëmarrësve iu përgjigjen pozitivisht.

Koeficienti i këtyre përgjigjeve nga totali i familjeve në vënd do të sugjeronte se 80,640 familje shqiptare zotërojnë armë.

Tabela 20: Llogaritja e mbajtjes së AVL të përdorura në familje, bazuar në pyetjen e studimit të familjeve 'A keni armë?'

Metoda 3: HHS 3 'A keni armë?' (e zhvlerësuar)

11.2% e familjeve	80,640	
x Armë për familje	x (i ulët)	x (i lartë)
	1.143	1.58
– Armë me leje	65,747	
= Totali	26,425	61,664

Përdorimi i koeficientëve mbi përqindjen e familjeve që pohojnë mbajtjen e armëve në HHS gjeneron një nivel zotërimi total të llogaritur prej 92,172–127,411. Zbritja e atyre që janë regjistruar ligjërisht (65,747), përgjigjet ndaj kësaj pyetjeje do të çonin në një total prej 26,425–61,664 armësh pa leje. Kjo shifër nuk përputhet si me numrin e armëve të ditura për të qënë të pallogaritura që prej grabitjes së rezervave dhe me përqindjen në të cilën armët janë dorëzuar para se ligji i amnistisë të mbaronte nga fundi i majit të vitit 2005. Gjithashtu, studime të ngjashme kanë shënuar një tendencë të familjeve për të mohuar zotërimin e armëve të zjarrit sepse ato nuk janë të gatshme të tregojnë se po shkelin ligjin. Kjo do të shpjegonte përse llogaritja e përfutur nga përgjigjet për këtë pyetje është shumë më e ulët sesa llogaritjet e nxjerra nga metodat e tjera. Kjo llogaritje e fundit nuk trajtohet si një llogaritje e besueshme nga ekipi kërkimor.

Armëmbajtja pa leje: familje apo grupe kriminale?

Vetëm 28.2 përqind e pjesëmarrësve në studimin e familjeve mendonin se armët e zjarrit të paregjistruara mbaheshin nga familjet në Shqipëri, ndërsa 94.7 përqind menduan se grupet kriminale zotëronin AVL.²⁷³ Kjo e forcoi hipotezën se individë ose grupe të caktuara ruajnë një sasi të konsiderueshme të AVL në masë të grabitura, e cila mund t'i shtohet totalit të disa mijra armëve pa leje dhe të shpjegojë më tej përse edhe dy llogaritje më të besueshme të bazuara në studimin e familjeve bien poshtë shifrave që dalin nga llogaritjet e bazuara në zbritjen nga totali i armëve të grabitura në 1997. Këto të fundit janë paraqitur si llogaritje më të besueshme, pasi kanë të bëjnë me shifrat e njohura të armëve nga një pikë e caktuar në kohë që mund të supozohet të mbetet në Shqipëri, nëse ato nuk mund të llogariten në mënyrë të besueshme diku tjetër.

3.5.3 Blerja e armëve pa leje

Oficerët policorë në Berat, Fier, Gjirokastrë dhe Kukës deklaruan se ata nuk kishin treg të zi armësh në zonat e tyre.²⁷⁴ Megjithatë, të gjithë ata vazhdonin të deklaronin se ishte e mundur të përftoje një armë zjarri pa leje në zonën e tyre. Për shëmbull, një oficer policie nga Kukësi deklaroi se megjithëse nuk ka treg të zi, dikush mund të blente armë në mënyrë të paligjshme nga familjet e varfra në vënde si Tropoja, të cilët do të ishin të gatshme të shisnin një pushkë automatike për rreth €40. Ndoshta, konfuzioni mbi atë çka përbën një 'treg të zi' varet nga përcaktimet individuale. Mund të jetë e vërtetë se nuk ka më tregje të zeza fizike për armë, krahasuar me 'pazaret e armëve pa leje' që ishin të pranishme në Bajram Curri dhe Tropojë në fund të viteve 90, por ky zyrtar ishte në gjendje të jepte një vlerësim për çmimin e një arme të paregjistruar. Të

²⁷³ Krahasoni grafikun në seksionin 3.5.4 – 'Perceptimet e zotërimit të AVL nga civilët' duke treguar përgjigjet për pyetjen 'Për mendimin tuaj, cilat grupe zotërojnë armë zjarri të regjistruara dhe të paregjistruara në Shqipëri?'

²⁷⁴ Intervista, zyrtar i Ministrisë së Brëndshme, 30 korrik 2005; zyrtar i Ministrisë së Brëndshme, 30 korrik 2005; zyrtar i Ministrisë së Brëndshme, gusht 2005; zyrtar i Ministrisë së Brëndshme, 27 prill 2005; zyrtar i Ministrisë së Brëndshme, 6 gusht 2005.

intervistuarit nga Berati, Gjirokastra, Kukësi dhe Shkodra na dhanë çmimet e llogaritura për AVL të ndryshme në rajonet e tyre, siç tregohen në tabelën e mëposhtme:


Tabela 21: Llogaritjet për çmimet e tregut të zi të AVL në Shqipëri

	armë zjarri	AK-47	pistoletë e tipit TT
Berat ²⁷⁵	€80–€160	–	–
Gjirokastra ²⁷⁶	–	€25–€40	€245–€570
Kukës ²⁷⁷	–	€15–€200	–
Shkodër ²⁷⁸	–	€110	€240–€400

Çmimet e dhëna në tabelë mund të na paraqesin një guidë të dobishme për diferencën relative në çmime për këto tipe armësh në pjesë të ndryshme të Shqipërisë. Në përgjithësi besohet se në Shqipëri pushkët automatike dhe jo-automatike janë shumë më të lira se pistoletat dhe kjo ndoshta na sugjeron se kërkesa për pistoletë është ende e lartë dhe/ose furnizimi është më kompleks. Përkundrazi, dikush mund të supozojë se një numër i madh pushkësh automatike dhe jo- automatike janë ende në qarkullim pa leje, pavarësisht nga fakti se edhe ato mund të përbëjnë shumicën e AVL që janë konfiskuar dhe dorëzuar vullnetarisht. Sigurisht, armët luftarake të zjarrit si AK-47 janë më të vështira të fshihen në krahasim me një pistoletë.

Megjithatë, ishte një konsensus i përgjithshëm midis pjesëmarrësve nga takimet formale dhe informale që nuk ishte e vështirë të siguroje një armë në Shqipëri. Gjithsesi, hyrja e drejtpërdrejtë në tregun e zi nuk do të ishte domosdoshmërisht rruga e parë për t'u ndjekur. Shumë të intervistuar sugjeruan që kërkimet fillestare të bëheshin brënda fisit të dikujt ose rrethit të miqve, me supozimin se nuk do të ishte e vështirë të përfitoje një armë. Në një studim të zhvilluar nga Qendra për Studime Rurale në 2002, 61 nga 569 pjesëmarrës shprehën pikëpamje sesi dikush mund të siguronte një armë në Shqipëri. Nga këta 61 pjesëmarrës, 90 për qind deklaruan se çdo anëtar i familjes dhe të afërm, miq të fqinjve mund të ishin metoda kryesore për të siguruar një armë.²⁷⁹ Në kërkimin për këtë studim të zhvilluar nga ISO në vitin 2005, 17.3 për qind e pjesëmarrësve deklaruan 'një shok' dhe 14.3 për qind thanë 'familja' do të ishin njerëzit e parë tek të cilët ata do të drejtoheshin nëse kishin nevojë për armë.

Në qoftë se për ndonjë arsye do t'ju nevojitej një armë, ku do të shkonit fillimisht?



Ndërsa opsionet më të përhapura në studim ishin 'dyqan' dhe 'kontrabandist', njëri prej diskutimeve të fokus grupit dha përgjigjen e mëposhtme tipike:

Po, nuk është aq e vështirë [të gesh një armë në Shqipëri]. Nëse dëshironi, ju mund ta

²⁷⁵ Intervista, zyrtar i Ministrisë së Rendit, 30 korrik 2005.

²⁷⁶ Intervistat, zyrtar i Ministrisë së Rendit, 6 gusht 2005; zyrtar i Ministrisë së Rendit, 6 gusht 2005.

²⁷⁷ Intervista, zyrtar i Ministrisë së Rendit, 27 Prill 2005

²⁷⁸ Intervista, zyrtar i një organizate ndërkombëtare, 13 qershor 2005.

²⁷⁹ Përqindja kishte rënë si më poshtë: 19.7 për qind deklaruan anëtarët e familjes; 26.2 për qind thanë shokët; 36.1 për qind deklaruan të afërmit dhe 8.2 për qind dhanë përgjigje për fqinjët. Burimi: op cit Qendra për Studime Rurale, Tabela 36.

gjeni atë. Duhet thjesht të keni paratë e duhura. Shkoni te tregu i zi dhe ata do t'jua sjellin menjëherë.

Fokus Grupi, Shkodër, Femër, gusht 2005.

3.5.4 Perceptimet mbi mbajtjen e armëve të vogla dhe të lehta nga popullsia civile

Si me përgjigjet për studime të tjera të SEESAC në lidhje me perceptimet mbi mbajtjen e AVL, përqindje më të larta janë konkluduar kur pjesëmarrësve iu kërkua të vlerësonin përqindjen e familjeve në Shqipëri që mbanin armë zjarri, krahasuar me llogaritjet për lagjen dhe familjen e shokët. Njëkohësisht, u vu re një tendencë në rritje për numrin e përgjigjeve 'nuk e di', ndërsa llogaritjet iu afruan atributimit të familjes. Kështu, 20.1 për qind e pjesëmarrësve u përgjigjën 'nuk e di' kur iu kërkua të vlerësonin sesa familje në Shqipëri kishin një armë zjarri funksionale, ndërsa 40.5 për qind e pjesëmarrësve dhanë të njëjtën përgjigje kur iu kërkua të bënë vlerësimin për miqtë dhe familjen e tyre.

Tabela 22: Për mendimin tuaj, sa për qind e familjeve në shoqërinë shqiptare ka të paktën një armë zjarri funksionale ?

llogaritja	rajoni				Totali
	Veri	Qendër	Jug	Tirana	
më pak se 20%	23.5%	28.9%	26.2%	9.0%	23.3%
21–40%	27.6%	22.0%	29.6%	35.0%	28.6%
41–60%	18.4%	14.7%	12.5%	25.0%	16.3%
61–80%	7.7%	14.2%	0.8%	9.0%	6.3%
80%+	5.9%	11.2%	0.6%	2.5%	4.2%
nuk e di	15.4%	9.1%	28.6%	18.0%	20.1%
asnjë përgjigje	1.5%	0.0%	1.6%	1.5%	1.3%
Totali	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Tabela 23: Për mendimin tuaj, sa për qind e familjes në lagjen tuaj ka të paktën një armë zjarri funksionale ?

llogaritja	rajoni				Totali
	Veri	Qendër	Jug	Tirana	
më pak se 20%	39.3%	53.4%	45.8%	36.0%	44.2%
21–40%	12.9%	15.5%	11.9%	10.5%	12.6%
41–60%	13.6%	6.0%	2.4%	4.5%	6.0%
61–80%	5.1%	0.0%	0.2%	0.0%	1.3%
80%+	1.8%	0.0%	0.2%	0.5%	0.6%
nuk e di	26.1%	22.8%	35.5%	45.0%	32.5%
asnjë përgjigje	1.1%	2.2%	4.0%	3.5%	2.9%
Totali	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Tabela 24: Për mendimin tuaj, sa për qind e miqve dhe familjes suaj kanë të paktën një armë zjarri funksionale ?

llogaritja	rajoni				Totali
	Veri	Qendër	Jug	Tirana	
më pak se 20%	41.9%	43.1%	38.3%	25.5%	37.9%
21–40%	11.4%	6.5%	6.3%	0.5%	6.5%
41–60%	6.3%	3.0%	2.0%	1.0%	3.0%
61–80%	4.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.9%
80%+	1.5%	0.0%	0.2%	0.0%	0.4%
nuk e di	31.6%	37.1%	41.9%	53.0%	40.5%
asnjë përgjigje	3.3%	10.3%	11.3%	20.0%	10.8%
Totali	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%


Për të gjitha nivelet, personat me vendndodhje në veri të Shqipërisë dhanë llogaritje më të larta për numrat e familjeve me të paktën një armë zjarri funksionale, dhe vleresimet më të ulta u dhane nga të intervistuarit nga Tirana. Megjithatë, në total, më shumë se gjysma e pjesëmarrësve besuan se më pak se dyzet për qind e familjeve në lagjen e tyre dhe në Shqipëri kishin një armë zjarri.

Më intrigues ishte fakti se kur iu kerkua të llogaritnin përqindjen familjeve dhe shokëve me të paktën një armë zjarri funksionale, më shumë se dyzet për qind e personave që u përgjigjën, deklaruan 'nuk e di'.²⁸⁰ Personat nga jugu që u përgjigjën kishin përqindjen më të lartë të shprehjes "nuk e di" në lidhje me llogaritjet e përqindjes së familjeve me armë zjarri në rrafsh kombëtar. Tirana kishte përqindjen më të lartë të shprehjes "nuk e di" të të intervistuarve në lidhje me lagjen, shokët dhe familjen. Kjo shkallë e lartë mosdije mund të jetë rezultat i faktit se personat iu përgjigjën pyetësorit ndershmërisht, duke u shprehur se kjo llogaritje ishte e vështirë për t'u bërë. Megjithëse dikush do të ishte ndoshta më skeptik për numrin e madh të përgjigjes 'nuk e di' në lidhje me shokët dhe familjen, llogaritjet në grupet fokus për mbajtjen e armëve të zjarrit në rajonin e tyre gjithashtu varionin konsiderueshëm duke sugjeruar se "nuk e di" është ndoshta përgjigjia më e ndershme.

Kur u pyetën në lidhje me nivelin e armëve në lagjen e tyre, 36.8 për qind u përgjigjën sërish se nuk e dinin, ndërsa 45.4 për qind e personave besuan se numri i armëve në lagjen e tyre ishte 'shumë i pakët', 11.8 për qind menduan se niveli ishte i pranueshëm dhe 3.4 për qind menduan se ishin shumë.²⁸¹

Megjithëse vetëm 11.2 për qind e pjesëmarrësve pohuan se kishin një armë në shtëpi, 43.7 për qind e tyre deklaruan se ata kishin patur një armë në shtëpi në një periudhë në të kaluarën. (sic tregohet në grafikun e mëposhtëm). Pesëdhjet për qind e pjesëmarrësve ruralë deklaruan se ata në një periudhë kohore kishin patur një armë në shtëpi, krahasuar me 31.5 për qind të pjesëmarrësve urbanë.


A keni pasur ndonjëherë armë në shtëpi?




Katërmbëdhjet për qind e pjesëmarrësve ruralë deklaruan se ata kishin aktualisht një armë në shtëpi ndërsa shtatë për qind e pjesëmarrësve urbanë bënë një deklaram të tillë.

²⁸⁰ Në një pike tjetër, personat u pyetën nëse mendonin se kishte armë në lagjen e tyre. 44.4 për qind e të anketuarve deklaruan se nuk e dinin nëse fqinji i tyre kishte armë apo jo, ndërsa 15.6 për qind deklaruan 'po' dhe 38 për qind deklaruan 'jo'. Dy përqind e tyre nuk iu përgjigjën kësaj pyetjeje.

²⁸¹ Gjashtëdhjet e gjashtë për qind e pjesëmarrësve nga pjesa qendrore e Shqipërisë menduan se kishte shumë pak armë në lagjen e tyre, me njëzet e dy për qind të pjesëmarrësve nga kjo zonë që deklararonin se nuk e dinin. Pesëdhjet e një për qind e pjesëmarrësve të vendosur në Tiranë deklaruan se nuk e dinin sa armë kishte në lagjen e tyre.

A keni armë në shtëpi tani?

Kur u pyetën se çfarë u kishte ndodhur armëve të tyre, shumë nga pjesëmarrësit që raportuan se kishin patur një armë, deklaruan se i kishin dorëzuar vullnetarisht ose se ua kishte marrë policia. Nga ata të moshës mbi 61 vjec, 36 për qind deklaruan se policia u kishte marrë armët, krahasuar vetëm me 18 për qind të grupmoshës 18–30 vjec. Te anketuarit e moshës mbi 61 vjec kishin numrin më të vogël të pjesëmarrësve që deklaruan se i kishin dorëzuar vullnetarisht armët e tyre me 43 për qind, ndërsa 64 për qind e grupmoshës 41 deri 50 vjec deklaruan se i kishin dorëzuar vullnetarisht armët e tyre. Në veri të Shqipërisë, 54.5 për qind deklaruan se i kishin dorëzuar vullnetarisht armët e tyre, njëzet e katër për qind pretenduan se ata ende i kishin armët, tetë për qind i kishin shitur dhe katër për qind e pjesëmarrësve deklaruan se jua kishte marrë policia. Rajoni me përqindjen më të lartë të pjesëmarrësve që pretendonin të kishin dorëzuar armët vullnetarisht ishte në jug të Shqipërisë (65 për qind), ndjekur nga veriu (54.5 për qind), më pas Tirana (49 për qind) dhe më tej qendra (47 për qind). Përgjigjet mund të krahasohen me përqindjet e armëve nga rajoni të dëmtuara të riparuar, duke përdorur statistikën nga tabela e përfshirë në seksionin 6.4 – ‘Rezultatet nga amnistia për proceset e grumbullimit të armëve’. Këto shifra konfirmojnë përgjigjet e studimit të familjeve në shënimin se sasia më e madhe e armëve në të vërtetë ishte riparuar në jug (72.8 për qind), por gjithashtu tregon se suksesi ishte në fakt shumë më i madh në qendër (35.6 për qind të riparuar), sesa në veri (23.3 për qind të riparuar).²⁸² Kishte edhe variacion të konsiderueshëm rajonal në sasinë e pjesëmarrësve që raportonin se policia jua kishte marrë armët që ata zotëronin më parë: sasia ishte më e madhe në qendër të Shqipërisë (38 për qind), ndjekur nga pjesa jugore (15 për qind) dhe Tirana (gjashtë për qind).

Çfarë ndodhi me armën që keni pasur?


Është interesante të vërehet se nëse sasia e familjeve që pretendojnë se arma e tyre ishte dorëzuar ose konfiskuar (31.0 për qind) është përdorur për të projektuar një total armësh të grumbulluara ose të konfiskuara, bazuar në numrin e familjeve në vënd

²⁸² Përqindja për qendrën del nga totali i raportuar nga Drejtoria e Përgjithshme Rajonale për rrethet Berat, Diber, Durres, Elbasan, Fier dhe Tiranë; veriu del nga totali GDD në Kukës, Lezhë dhe Shkodër; jugu del nga totali GDD për rrethet Gjirokastrë, Korçë dhe Vlorë.

(720,000) kjo do të sugjeronte se një minimum prej 223,200 armësh ishte grumbulluar ose konfiskuar nga familjet në Shqipëri në të gjitha kohërat, megjithëse çdo familje që ka dorëzuar një armë mund të ketë dorëzuar më shumë se një armë mesatarisht. Ndërkohë, grumbullimi i armëve përpara vitit 1997 do të pritej të formonte një sasi të grumbullimeve/konfiskimeve të raportuara nga pjesëmarrësit për këtë pyetje; kjo shifër do të përputhej me shifrën zyrtare prej 222,918 armësh të vogla dhe armatimesh të lehta që prej vitit 1997.


Në pikën kur do pyetesh se në cilat pjesë të shoqërisë shqiptare, armët e zjarrit kishin më tepër të ngjarë të mbaheshin përveç policisë dhe forcave të armatosura, shumica dërrmuese e pjesëmarrësve deklaruan ‘në duart e kriminelëve’. Megjithatë, pothuajse gjysma e pjesëmarrësve sugjeruan biznesmenët, ndërsa më shumë se çereku i pjesëmarrësve menduan se familjet zotëronin armë të vogla dhe të lehta. Grafiku i mëposhtëm tregon rezultatet e një pyetjeje se cilat grupe mendohen të zotërojnë armë zjarri të regjistruara dhe të paregjistruara në Shqipëri:

Sipas mendimit tuaj cilat grupe mbajnë armë me leje dhe pa leje në Shqipëri?



Kur u bë pyetja se cilat grupe zotërojnë armë zjarri të regjistruara dhe të paregjistruara në Shqipëri, 39 për qind e pjesëmarrësve nga qendra e vëndit i konsideruan familjet si një nga këto grupe, krahasuar vetëm me 18.5 për qind të pjesëmarrësve nga jugu i Shqipërisë. Kur u bë pyetja se kush duhet të lejohej të mbante armë zjarri në shtëpi, pothuajse gjysma e pjesëmarrësve mbështetën idenë që policia të lejohej të vepronte në këtë mënyrë, ndërsa përqindja ra në 9.6 në lidhje me ushtrinë (megjithëse 27 për qind e pjesëmarrësve në pjesën qendrore të Shqipërisë e mbështetën këtë opsion).

Kush duhet të lejohet që të mbajë armë zjarri në shtëpi?



Në studimet e vitit 2002 dhe 2004 nga Qendra për Studime Rurale, opsioni i ‘policisë’ nuk ishte përfshirë me rezultatin se në 2002, 77.2 për qind dhe në 2004 73 për qind e pjesëmarrësve deklaruan se askush nuk duhet të ketë armë në shtëpi.²⁸³ Në studimin e


²⁸³ Megjithë këtë qëndrueshmëri të dukshme, shpërndarja rajonale e atyre që japin këtë përgjigje kaloi konsiderueshëm nga Kukësi dhe Vlora në 2002 te Durrësi dhe Lezha në 2004, duke sugjeruar se përshtypjet mbi këtë çështje janë të ndryshueshme, pavarësisht nga qëndrueshmëria e dukshme në reagimin e përgjithshme ndaj dy studimeve. Pjesëmarrësit në anketimin e vitit 2002 nën 18 vjeç dhe mbi 60 mbështetën fuqimisht idenë se askush nuk duhet të zotërojë armë zjarri, përkatësisht me 92.3 për qind dhe 80.6 për qind. Burimet: op cit Qendra për Studime Rurale, tabela 44; op cit Qendra për Studime Rurale dhe Zhvillim të Qëndrueshëm, fq. 35.

vitit 2005 të kryer nga ISO në lidhje me këtë raport, 17.5 për qind e meshkujve dhe 20 për qind e femrave menduan se askush nuk duhet të lejohej të mbante armë zjarri në shtëpi. Mesatarisht, 28 për qind e pjesëmarrësve urbanë dhe 16 për qind e atyre ruralë e mbështetën këtë ide.

Në vitin 2002, një mesatare prej dhjetë për qind mendonin se vetëm biznesmenët duhet të lejoreshin të mbanin armë, me deklaratën më fuqimisht të mbështetur në Durres (17.9 për qind), Shkodër (16.7 për qind) dhe Gjirokastrë (14 për qind), pa asnjë pjesëmarrës në Kukës që të ishte dakord me këtë pikëpamje. Në studimin e vitit 2004, mbështetja e këtij opsioni ishte ngritur në një mesatare prej njëzet për qind të pjesëmarrësve, me mbështetësit më të fuqishëm tashmë në Vlorë (34.8 për qind) dhe Tiranë (25.2 për qind). Niveli i mbështetjes për këtë opsion në Durres kishte rënë në 11.9 për qind, ndërsa një përqindje e ngjashme e pjesëmarrësve në Gjirokastrë (14 për qind) dhe Shkodër (17.9 për qind) vazhdoi të mbështeste këtë opsion. Ideja se çdo familje duhet të kishte një armë të marrë mesatarisht në 11.1 për qind në vitin 2002, me pothuajse një të tretën e pjesëmarrësve në Lezhë që ishin dakord me këtë ide (30.4 për qind) dhe një e pesta në Durres (19 për qind). Të gjitha zonat e tjera kishin përgjigje poshtë kësaj mesatareje. Në vitin 2004, niveli i përgjithshëm i mbështetjes ndaj këtij opsioni kishte rënë në 5.1 për qind, me mbështetjen në Lezhë, duke rënë në 6.6 për qind dhe duke u ngritur në 20.5 për qind nga 5 për qind në Kukës. Një interpretim i këtyre luhatjeve, në dukje të mëdha, sipas publikut është se opinionet e shprehura nuk jepen fuqimisht dhe kanë të ngjarë të rregullohen pozitivisht nëpërmjet aktiviteteve të sensibilizimit të publikut; e dyta është se ato reflektojnë perceptime që luhaten shpejt midis pjesëmarrësve të sigurisë së mjedisit të tyre.

Kryetari i bashkisë së Fierit foli për mundësinë se grupe të ndryshme etnike në rajon mund të kishin qëndrime të ndryshme ndaj armëve dhe kështu raportohen shifra të ndryshme armësh.²⁸⁴ Megjithatë, në përgjithësi, armëmbajtja në Shqipëri është parë si më e përhapur mes gjinisë mashkullore më tepër sesa mes ndonjë etnie specifike. Shumë të intervistuar deklaruan se grupi kryesor problematik janë djemtë e rinj adoleshentë dhe ata të 20-at, të cilët janë përfshirë në konflikte, të cilat ishin përkeqësuar nga mundësia për të gjetur lehtësisht një armë.²⁸⁵ Në studimin e ISO të vitit 2005, njerëzit midis 19 dhe 25 vjeç ishin konsideruar si grupmosha që kishte më shumë të ngjarë të zotëronte armë zjarri.

Cilat grupmosha kanë më shumë të ngjarë që të mbajnë armë?




Megjithatë, disa të intervistuar argumentuan se shumë mesoburra dhe në moshë më të vjetër mendoheshin të mbanin armë të paregjistruara, si kreu i familjes dhe ndanjëherë, tradicionalisht djali më i madh zotëronte armë. Megjithatë, në përgjithësi shumë të intervistuar folën për ndryshimet midis armëmbajtjes në qytet, zonave urbane dhe rurale, dhe zonat rurale mendoheshin të kishin një numër më të madh armësh për frymë sesa zonat urbane. Kjo ka ndodhur edhe në studimin e ISO-s të vitit 2005:

²⁸⁴ Intervista, zyrtar i qeverisë vendore, 12 maj 2005.

²⁸⁵ Intervista, ish zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 27 prill 2005; zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 13 qershor 2005. Kjo ishte gjithashtu një përgjigje e përbashkët në të gjitha intervistat me grupet fokus, pa dallime gjinore.


Në cilat pjesë të Shqipërisë janë më të përhapura armët e zjarrit (përveç policisë, ushtrisë, xhandarmarisë etj)?



Niveli më i lartë i armëmbajtjes në zonat rurale përgjithësisht mendohet të jenë nxitur nga fakti se prania më e ulët e policisë i shërben një popullsie më të izoluar, e cila si rrjedhim beson në nevojën për vetëmbrojtje. Arsyeja tjetër kryesore e dhënë për nivelet më të larta të armëmbajtjes në zona rurale ishte tradita. Megjithatë, u argumentua se nuk është thjesht armëmbajtja në përgjithësi që është më e lartë në zonat rurale, por armëmbajtja pa leje, e paregjistruar. Ndryshimet u përmendën edhe në lidhje me llojet e armëve që dikush duhet të presë të gjejë në zonat urbane dhe rurale. Për shëmbull, dikush do të priste që kryesisht të ketë pistoletë në qytet, ndërsa nëpër fshatra dikush do priste të gjente më shumë pushkë dhe automatikë.

Disa pjesëmarrës sugjeruan që armëmbajtja pa leje në qytetet kryesore të Shqipërisë është një problem që shqiptarët nga zonat rurale e sjellin me vete kur ata zhvendosen në zonat urbane.²⁸⁶ Të tjerët preferuan të theksonin disa qytete si më problematike në lidhje me armët, në krahasim me qytetet e tyre. Kështu, për shëmbull, një pjesëmarrës krahasoi në mënyrë të favorshme qytetin e tij të Fierit me Vlorën, duke argumentuar se Fieri nuk kishte problem armësh, ndërsa Vlora po.²⁸⁷ Megjithatë, sipas një prokurori të rrethit Fier, zona kishte një përqindje më të lartë për frymë të vrasjes dhe armëmbajtjes pa leje sesa Durrësi, me një numër të intervistuarish që sugjerorin se armëmbajtja pa leje aktualisht është e përhapur në zonë, pasi rastet e armëmbajtjes pa leje kishin qënë midis rasteve më të shpeshta të ngritura në gjykatë.²⁸⁸ Megjithatë, në përgjithësi, shumë të intervistuar dhe pjesëmarrës të studimit deklaruan se pjesa veriore e Shqipërisë ka më shumë armë zjarri në Shqipëri.

në cilat pjesë të Shqipërisë janë më të përhapura armët?



Sipas studimit të ISO-s të vitit 2005 të zhvilluar për këtë raport, vendi më i zakonshëm për të parë sesi armët e zjarrit përdoren në komunitet në Shqipëri është gjatë festave. Megjithatë 19.9 për qind e pjesëmarrësve deklaruan se dikush nuk mund t'i shohë asnjëherë njerëzit të mbajnë armë zjarri në Shqipëri (duke përjashtuar policinë ose oficerët e ushtrisë), 41.3 për qind e pjesëmarrësve pretenduan të kishin dëshmuar personalisht përdorimin e armëve të zjarrit (47.5 për qind e pjesëmarrësve meshkuj dhe 35 për qind e pjesëmarrësve femra). Nuk kishte ndryshime të dukshme rajonale për këtë, të cilat mund të ndikonin në perceptimin se ka më shumë armë zjarri në veriun e vendit. Një përqindje më e madhe e pjesëmarrësve më të moshuar pohuan se kishin dëshmuar një situatë që përfshinte armët e zjarrit- mesatarisht, 50 për qind e personave mbi 65 vjeç kishin dëshmuar përdorimin e një arme zjarri krahasuar me 41.5 për qind të grupmoshave nga 18 në 30 vjeç. Studimi gjithashtu sugjeroi se dikush ka më shumë të ngjarë të dëshmojë përdorimin e një arme zjarri në një zonë rurale sesa në një zonë urbane, me 46 për qind të pjesëmarrësve ruralë, duke pretenduar të kishin


²⁸⁶ Intervista, zyrtari i Ministrisë së Brëndshme, 15 maj 2005.

²⁸⁷ Intervista, zyrtari i Ministrisë së Mjedisit, 14 maj 2005. Shumë pjesëmarrës nga Fieri mendonin se nuk kishte kulturë armësh në Fier dhe asnjë traditë reale të mbajtjes së armëve. Intervista, zyrtari i Ministrisë së Mjedisit, 14 maj 2005; zyrtari i Ministrisë së Brëndshme, 14 maj 2005; përfaqësues i OJF, 15 maj 2005; zyrtari i qeverisë lokale, 12 maj 2005.

²⁸⁸ Intervista, zyrtari i Ministrisë së Brëndshme, 15 maj 2005; zyrtar i MOJ, 16 maj 2005.


dëshmuar përdorimin e një arme zjarri krahasuar me 36 për qind të pjesëmarrësve urbanë.

Në çfarë situatash ku janë përdorur armë zjarri keni qenë personalisht dëshmitar?



Shpeshtësia me të cilën armët e zjarrit janë parë në publik është gjithashtu disi e ulët, duke marrë në konsideratë llogaritjet e armëve të zjarrit të paregjistruara lirisht në Shqipëri. Kjo mund të mbështesë tezën se një sasi e konsiderueshme armësh pa leje mbahen në masë më tepër sesa nga familjet individuale ose mund të sugjerojë që shumë armë mbahen në mënyrë të fshehtë për raste emergjence më tepër sesa për përdorimin e shpeshtë ose paraqitjen haptazi të tyre.

Sa shpesh shihni njerëz që mbajnë armë zjarri në lagjen tuaj (duke mos përfshirë policinë ose oficerat e ushtrisë)



Pjesëmarrësit e grupit të fokusuar shtuan dallimet e të dhënave të mbledhura nga studimi. Ata sugjeruan një ndryshim të dukshëm midis vizibilitetit të armëve të zjarrit në Shkodër dhe Tiranë, me armët e zjarrit, me një pamje më të zakonshme në të parën. Megjithatë, një prej informacioneve më interesante erdhi nga pjesëmarrësit në një fokus grup në Tiranë, i cili deklaroi që:

Ndoshta ne nuk jemi mësuar të shohim armë të vogla dhe të lehta, por jemi mësuar me praninë e tyre. Edhe nëse njerëzit dëgjojnë një të shtënë arme, ata vrapojnë për dy sekonda, por më pas kthehen shpejt. Jemi kuriozë, por ende indiferentë. Nuk na pëlqen ligji, sepse, nëse do ta pëlqenim, do t'i tregonim policisë se pamë dikë të vriste me armë. Ne nuk e bëjmë kurrë këtë, sepse në të vërtetë jemi të frikësuar nga personi që mban armën. Do të thosha se ne jemi të frikësuar edhe nga vetë policët.


Fokus Grupi, Tirana, Mashkull, gusht 2005.

3.5.5 Arsyet për mbajtjen e armëve të vogla dhe të lehta

Dy të intervistuar nga Ministria e Brendshme nxoren si motivin kryesor për armëmbajtje në Shqipëri.²⁸⁹ mbrojtjen e vetes dhe familjes. Njëri prej këtyre zyrtarëve bëri komentin e mëtejshëm se do të ishte e vështirë të parashikohej dënimi i këtyre njerëzve me burgim.²⁹⁰ Tjetri, një figurë kyce në procesin e grumbullimit të armëve, deklaroi se ata që ishin të vetëdijshëm se fqinjët e tyre mbanin armë, nuk ishin të gatshëm të çarmatoseshin.²⁹¹ Ai gjithatë theksoi se për disa shqiptarë, afërsia me një zonë konflikti aktual ishte një faktor motivues për mbajtjen e armëve, pasi armët mund të jenë asete fitimprurëse nëse një kërkesë për armë e nxitur nga konflikti do të rishfaqej në të ardhmen.²⁹² Ai gjithashtu tërhoqi vëmendjen për nivelet e larta të pasigurisë (dhe si rrjedhim të armëmbajtjes pa leje) midis emigrantëve që banojnë në veri të vëndit.²⁹³ Një zyrtar i tretë i Ministrisë së Brendshme theksoi rolin e traditës si një motiv për armëmbajtje.²⁹⁴

Pyetja kryesore e studimit të brendshëm për skematizimin e arsyeve për mbajtjen e armëve të vogla dhe të lehta iu kërkonte njerëzve të selektonin tre arsye kryesore të armëmbajtjes. Ekipi studimor hoqi opsionin e ‘mbrojtjes së vetes, familjes dhe pronës’ nga pyetësi i studimit të brendshëm, pasi ndihej që ato ishin arsye kryesore që do të jepeshin për armëmbajtjen.²⁹⁵ Opsionet e zgjedhura shfaqen në grafikun e mëposhtëm:

Përveç vetëmbrojtjes, mbrojtjes së familjes dhe pronës, cilat janë tre arsye të tjera për të cilat njerëzit mbajnë armë zjarri?



Është interesante të vërehet se arsyet e pranuar ligjërisht në lidhje me mbajtjen e armëve (dmth gjuajtja në sport dhe gjuetia) ishin zgjedhjet më popullore për pjesëmarrësit, të ndjekura nga ‘hakmarrja’ dhe ‘përdorimi kriminal’. Nuk është e qartë nëse impakti i vitit 1997, zgjedhjet parlamentare të korrikut 2005 (pak përpara të cilave u zhvillua HHS) apo një kombinim i dy faktorëve ndoshta mund të shtynte pothuajse një të tretën e pjesëmarrësve të zgjidhnin ‘frikën nga mungesa e stabilitetit politik’. Sic pritej, në intervistat e fokus grupit, mbrojtja e vetes, familjes (në vecanti midis femrave) dhe pronës ishin shkaqet që përmëndeshin më shpesh për armëmbajtje. Në

²⁸⁹ Intervista, zyrtar i Ministrisë së Brëndshme, 23 Prill 2005; zyrtar i Ministrisë së Brëndshme, 14 Prill 2005.

²⁹⁰ Intervista, zyrtar i Ministrisë së Brëndshme, 23 Prill 2005.

²⁹¹ Intervista, zyrtar i Ministrisë së Brëndshme, 14 Prill 2005.

²⁹² Ibid.

²⁹³ Ibid.

²⁹⁴ Intervista, zyrtar i Ministrisë së Brëndshme, 21 Prill 2005.

²⁹⁵ Për shëmbull, në studimet e kryera nga Qendra për Studime Rurale në vitin 2002, 73.7 për qind të 377 pjesëmarrësve që dhanë një arsye për armëmbajtjen, deklaruan se shkaku kryesor për të patur një armë do të ishte mbrojtja e vetes dhe familjes së tyre. Kjo përgjigje ishte më populloreja në Shkodër (82.3 për qind), Gjirokastrë (82.6 për qind) dhe Lezhë (83.3 për qind) në vitin 2002. Megjithatë mbështetja për këtë opsion kishte rënë në 2004, këto 3 fusha ende gëzojnë mbështetjen më të madhe për këtë opsion – Shkodër (82 për qind), Gjirokastrë (68.2 për qind) dhe Lezhë (78.3 për qind). Ia vlen të theksojmë faktin se mbështetja për këtë opsion ra ndjeshëm në Kukës (nga 71.9 për qind në 53.7 për qind) dhe Tiranë (nga 67.6 për qind në 39.6 për qind). Arsyetja e dytë më e ndeshur që u paraqit ishte mbrojtja e biznesit privat, me 8.2 për qind të pjesëmarrësve që zgjedhën këtë opsion në vitin 2002, me mbështetjen më të fortë në Gjirokastrë (13 për qind) dhe Vlorë (15.9 për qind). Nga viti 2004, ky opsion kishte fituar më shumë mbështetje në të gjitha zonat, me pesë nga shtatë rajone në studim që kthenin dyfishin e mbështetjes së mesatares së vitit 2002 – Durres (19 për qind), Gjirokastrë (22.7 për qind), Kukës (16.7 për qind), Shkodër (17.7 për qind) dhe Vlorë (17.3 për qind). Burimet : op cit Qendra për Studime Rurale, tabela 38; op cit Qendra për Studime Rurale dhe Zhvillim të Qëndrueshëm, fq. 33.

intervista me fokus grupet për mbajtjen e armëve me leje të regjistruara në Shqipëri, u paraqitën arsyet e mëposhtme:

- Mbrojtja e vetes, familjes, pronës ose biznesit (pasi shteti nuk është në gjendje ta bëjë këtë);
- Mbrojtja e bagëtisë dhe pronës në zonat rurale;
- Mbrojtja e vetes në një konflikt midis familjeve, duke përfshirë gjakësinë;
- “Zgjidhja e problemeve” si konfliktet e pronave (një shkak i përhapur për njerëzit që jetojnë në zonat rurale);
- Bërja e krimeve;
- ‘Vazhdimi i traditës’;²⁹⁶
- Niveli i ulët arsimor;
- Si investim (për ta shitur në treg të zi ose me anë të skemës specifike të tregtisë që organizohet edhe nga shteti).

Sigurisht, jo të gjitha këto opsione ishin të njohura nga të intervistuarit dhe pjesëmarrësit e fokus grupit dhe shumë ide u debatuan si kultura e armëve në Shqipëri ose nevoja e njerëzve për të patur armë për vetëmbrojtje. Në shumë raste, të intervistuarit e fokus grupit deklaruan se dobësia e institucioneve shtetërore në kapjen e kriminelëve dhe sjelljen e tyre para drejtësisë ishte një shqetësim madhor, me një shkëmbim fokus grupi që justifikonte shprehimisht përdorimin e armëve të zjarrit për të vënë në vënd “drejtësinë”, kur shteti nuk mundet:

– Një person në Shqipëri është shpesh i detyruar të përdorë armën dhe të vrasë sepse shteti nuk i siguron atij mbrojtjen e nevojshme. Vecanërisht pas vitit 1997, shteti nuk merr asnjë përgjegjësi dhe asnjë besueshmëri se do të mbrojë njerëzit e tij, kështu që njerëzit janë të detyruar ta marrin këtë përgjegjësi dhe të mbrojnë veten dhe pronat e tyre. Sigurisht, ka edhe raste specifike.


– Kështu, mungesa e përgjegjësisë nga ana e shtetit, në kombinim me numrin e lartë të armëve në duart e njerëzve ka shkaktuar situatën aktuale.

[...] Kur nuk ka asnjë autoritet shtetëror, asnjë siguri, ju duhet t’i siguroni vetes mbrojtje. Ju dëgjoni gjithmonë nëpër lajme që kriminelin u arratis ose policia kapi kriminelin, por më pas ai u lirua nga gjykata.

Fokus Grupi, Shkodër, mashkull, gusht 2005


Anketimi i ISO për këtë studim gjithashtu i kërkoi pjesëmarrësve të sugjeronin kur ishte e pranueshme për njerëzit të mbanin një armë, me shumë pjesëmarrës që përsëri zgjodhën arsyet e pranuar ligjërisht “sportet dhe gjuetia”. Zbatimi jo i duhur i ligjit, mungesa e stabilitetit politik dhe frika nga fqinjët u konsideruan gjithashtu të pranueshme nga një perqindje midis një të katërtes dhe një të tretes së pjesëmarrësve. Përsëri, arsyet tradicionale u zgjodhën nga më pak sesa një e pesta e pjesëmarrësve.

Sipas mendimit tuaj, në çfarë rrethanash është e pranueshme që njerëzit të mbajnë armë?



Një sërë përgjigjesh interesante u morën kur pjesëmarrësve iu kërkua të shprehnin shkallën e tyre të miratimit ose mos-miratimit me fjalinë- “një shtëpi nuk është e sigurt pa një armë zjarri”.

**Deri në çfarë mase jeni dakort me shprehjen
“Shtëpia nuk është e sigurt pa armë?”**



Në kundërshtim me shifrat kombëtare të treguara në grafikun e mësipërm, gjashtëmbëdhjetë për qind e pjesëmarrësve nga pjesa veriore e Shqipërisë ishin fuqimisht dakord me këtë shprehje, ndërsa tetëmbëdhjetë për qind e pjesëmarrësve nga pjesa veriore e Shqipërisë nuk ishin dakord me këtë shprehje, duke sugjeruar se armëmbajtja për mbrojtjen e familjes është më e pranueshme dhe e përhapur në veriun e vëndit. Këtë perceptim kishin edhe të intervistuarit nga Ministria e Brendshme, të cilët e shpjegojnë atë në lidhje me besimin e pakët te shteti ligjor, mungesën e lartë të sigurisë midis popullsisë emigrante dhe një lidhje më të ngushtë me ‘kulturën e armëve’ në pjesën veriore të vëndit.²⁹⁷ Numri më i ulët i pjesëmarrësve që ishin fuqimisht dakord me këtë shprehje vinte nga Tirana, vetëm me dy për qind. Tirana kishte përqindjen më të madhe të pjesëmarrësve që nuk ishin fare dakord me këtë shprehje, rreth 46.5 për qind e pjesëmarrësve. Dallimet gjinore u regjistruan gjithashtu në përgjigjet me pesë për qind të femrave dhe nëntë për qind të meshkujve nga totali që ishin shumë dakord dhe 19.5 për qind e meshkujve dhe 25 për qind e femrave nuk ishin fare dakord me këtë shprehje.

²⁹⁷ Intervista, zyrtari i Ministrisë së Brendshme, 21 prill 2005, zyrtari i Ministrisë së Brendshme, 15 prill 2005.